



**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**“Auditimin Financiar”**

**BASHKIA KORÇË**

**Tiranë, shkurt 2026**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Faqe</b>
	Legjenda dhe shkurtime	3
<b>I</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>4-8</b>
a	Përshkrim i shkurtër i Bashkisë Korçë	4
b	Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij	4
c	Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe paraqitja e objektivave	4
d	Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave	4-5
e	Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve	5
f	Paraqitja e gjetjeve kryesore	5-6
g	Paraqitja e rekomandimeve kryesore	6
I.1	Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	7-8
<b>II</b>	<b>HYRJA</b>	<b>8-12</b>
1	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	8
2	Identifikimi i çështjes	8-9
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9
4	Përgjegjësitë e audituesve	9-10
5	Kriteret e vlerësimit	10
6	Standardet e auditimit	11
7	Metoda e auditimit	11-12
8	Dokumentimi i auditimit	12
<b>III</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	<b>12-73</b>
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin Bashkia Korçë	12-13
2	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	13-73
2.1	Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik për vitin 2024.	13-27
2.2	Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2024, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.	27-73
<b>IV</b>	<b>REKOMANDIME</b>	<b>74-79</b>

## **Lista e shkurtimeve**

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

## **I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE**

### **a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:**

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “*Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 974/1 prot., datë 13.10.2025, i ndryshuar me shkresën nr. 974/2 prot., datë 05.11.2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi **Bashkinë Korçë**, për periudhën 01.01.2024, deri më datën 31.12.2024. Për vitin 2024 realizimi i shpenzimeve është në vlerën 2,705,894 mijë lekë ndërsa të ardhurat e veta janë në vlerën 284,804 mijë lekë.

### **b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij:**

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Korçë për periudhën e aktivitetit 2024, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese, administruese dhe raportimit financiar, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

### **c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:**

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t’i bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- ✓ *Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm;*
- ✓ *Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore;*

### **d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave:**

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve dhe regjistrimit në pasqyrat financiare. Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerësojnë si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 77,254 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve. Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit si: Kontrolli aritmetik; Kontrolli me anë të pjesëve

justifikuese; Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese; Kontrolli i vlerësimit; Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi; Verifikimi i transaksioneve Intervistimi; Raporte dhe informacione; Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

#### **e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:**

Nga shqyrtimi i evidencave konstatohet se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 12 gjetje dhe ka dhënë 12 rekomandime të cilat i përkasin kategorisë Masa Organizative.

## **2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.**

### **f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:**

Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:

- Gjendja e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 75,078,510 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 134,796,778 lekë me një rritje në vlerën 59,718,268 lekë e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, për detyrime paga, tatime taksa dhe sigurime shoqërore dhe furnitorë e llogari të lidhura me to. Kjo llogari nuk kuadron me përmbledhësen e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” 43,513,278 lekë; 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 65,092,617 lekë; 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 4,868,646 lekë; 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 19,424,995 lekë; 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 2,685,069 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 22,615,430 lekë, ku totali shkon në vlerën 158,200,035 lekë me një diferencë në vlerën 23,403,257 lekë. Sipas informacionit kontabël llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është nënvlerësuar në vlerën 23,403,257 lekë.

- Nga auditimi u konstatua se në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” nuk është përfshirë vlera e aksioneve në shumën totale 722,601,823 lekë, që i përket pjesëmarrjes së Bashkisë Korçë në kapitalin e shoqërive tregtare dhe publike, konkretisht: “Tregu i shitjes me shumicë fruta e perime” Sh.A në vlerën 275,000,000 lekë (100% aksionare); “Korça” Sh.A (100% aksionare); “Qendra Sportive Korçë” Sh.A në vlerën 36,110,000 lekë (100% aksionare); Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë, me pjesëmarrje 28.29% ose 2,829,300 lekë sipas Marrëveshjes nr. 5767 prot., datë 28.09.2022; si dhe “KRËM” Sh.A, me pjesëmarrje 41% ose 1,533,523 lekë. Ndërkohë, llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më datë 31.12.2024 paraqitet në vlerën 0 lekë.

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 168,001,879 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 168,001,879 lekë, nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 17,164,315 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 127,694,438 lekë, me një diferencë në vlerën 23,143,126 lekë.

### **g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:**

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Bashkia Korçë, Drejtoria e Financës Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në bashkëpunim me NShMAC, QDZh të marrë masa që në pasqyrat financiare të konsoliduara të vitit 2025 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

- Nga Bashkia Korçë, Drejtoria e Financës Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të merren masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e veta” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.
- Bashkia Korçë, Drejtoria e Financës Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në bashkëpunim me NShMAC-në të evidentojë pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, në llogaritë 230 - 231 “Investime në proces” me kundërparti llogaritë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme”, 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar dhe në llogarinë 101 “Fondi Bazë”.
- Bashkia Korçë, Drejtoria e Financës Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në bashkëpunim me NShMAC, QDZh, SHFLV, QRZh, NShP, QAK, KSh të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2025 të kryej kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël.

### **I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit:**

Bazuar në rezultatet e auditimit në Bashkinë Korçë, KLSH ka dhënë **“Opinionin i modifikuar me rezervë”** për pasqyrat financiare. Referuar gjetjeve të auditimit për përmirësimin e gjendjes janë dhënë rekomandimet përkatëse të klasifikuara në rekomandime organizative.

#### **I. Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2024:**

##### **a. Opinioni i modifikuar<sup>1</sup> me rezervë:**

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Korçë për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

*Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, nga auditimi në pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Korçë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionin të “modifikuar, me rezervë”, e shprehur kjo në bazën për opinionin.*

##### **Bazat për opinionin e modifikuar<sup>1</sup> me rezervë:**

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej **77,254 mijë lekë**, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2024, si dhe anomalitë e mëposhtme:

- Nga auditimi i procesit të inventarizimit të Njësisë Shpenzuese Shtëpia e Fonjës “Lulet e Vogla” u konstatua se, në pasqyrat financiare nuk janë kryer veprimet sistemuese për pakësimin e vlerës totale prej 1,055,907 lekë që i përket llogarive 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në vlerën 21,000 lekë, 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 740,499 lekë dhe 327 “Inventar i imët” në vlerën 294,408 lekë që i përket aktiveve të asgjesuara, të cilat ndodhen ende në inventarin fizik të institucionit.

- Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është nënvlerësuar në vlerën 23,403,257 lekë;

Nga auditimi u konstatua se, në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” pasqyruar në mbyllje datë 31.12.2024, në vlerën 4,215,948,779 lekë është përfshirë vlera 710,580 lekë me emërtimin “Dhomë Serverash” që kanë të bëjnë me pajisje elektronike me emërtimet kamera, switch, aspiratorë profesional etj., të cilat i përkasin llogarisë 218 “Inventar ekonomik”. Regjistrimet e mësipërme kanë mbivlerësuar llogarinë 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 710,580 lekë dhe kanë nënvlerësuar llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në vlerë 710,580 lekë.

- Nga analiza e llogarisë 215 “Mjete transporti”, e pasqyruar në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2024 në vlerën 275,350,932 lekë, konstatohet se në përbërje të saj është përfshirë edhe vlera prej 950,000 lekë, e cila i përket një automjeti, pjesë e inventarit të Qendrës Rezidenciale të Zhvillimit.

Nga dokumentacioni i administruar dhe nga procesi i vlerësimit të aktiveve rezulton se automjeti në fjalë nuk ndodhet në gjendje pune dhe është vlerësuar nga komisioni përkatës si aktiv për jashtë përdorimit, ndërkohë që gjatë vitit 2024 nuk është ndjekur procedura e nxjerrjes nga përdorimi dhe, për rrjedhojë, vlera pasqyrohet ende në llogarinë 215 “Mjete transporti”.

Bazuar në sa më sipër, vlera prej 950,000 lekë, që përfaqëson koston historike të mjetit të dëmtuar, duhej të ishte trajtuar në kontabilitet si pjesë e llogarisë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”, dhe jo si mjet transporti funksional.

- Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)” për llogarinë 218 “Inventar ekonomik” është përllogaritur normë amortizimi i akumuluar, në vlerën 25,787,766 lekë (kosto historike) ose në masën 20%. Ndërkohë që nuk ka një ndarje të llogarisë 218/6 “Pajisje kompjuterike” nga aktivet e llogarisë bazë 218 “Inventar ekonomik” e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%.

- Në gjendjen e llogarive 202 “Studime dhe kërkime” në vlerën 57,852,130 lekë kosto historike është përfshirë vlera 1,166,300 lekë; 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 4,348,849,060 lekë kosto historike, është përfshirë vlera 414,379,276 lekë; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 4,544,741,034 lekë kosto historike është përfshirë vlera 767,685,964 lekë dhe 215 “Mjete transporti” në vlerën 219,912,236 lekë kosto historike është përfshirë vlera 8,833,400 lekë, të cilat janë të paanalizuara si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Këto vlera janë të trashëguara nga bilanci i ish-komunave Korçë të paanalizuara dhe ndikojnë në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

- Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” është nënvlerësuar në vlerën 722,601,823 lekë;

- Llogaria 231 “Për aktivet afatgjata materiale” është nënvlerësuar në vlerën 15,419,712 lekë;

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 168,001,879 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 168,001,879 lekë, nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 17,164,315 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 127,694,438 lekë, me një diferencë në vlerën 23,143,126 lekë.

## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 974/1 prot., datë 13.10.2025, i ndryshuar me shkresën nr. 974/2 prot., datë 05.11.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 13.10.2025, deri më 14.11.2025, në institucionin Bashkia Korçë u krye auditimi “Mbi auditimin financiar” për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024. Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. J. G. (Përgjegjës grupi)
2. A. D. anëtar
3. A. C. anëtar

## OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIME DHE METODOLOGJIA

**1. Objektivat dhe qëllimi:** Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2024, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t’i bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

**2. Identifikimi i çështjes:** Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi bazë risku, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t’i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes. Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Korçë si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi. Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat. Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Korçë.

**3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:** Titullari i institucionit në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Drejtori i Drejtorisë së Financës Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tjera.

**4. Përgjegjësitë e audituesve:** Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Korçë në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit. Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit. Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kutueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet. Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Korçë është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticismin profesional gjatë veprimtarisë audituese. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, paragrafi 44-51.

**5. Kriteret e vlerësimit:** Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.14, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm:

- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;
- Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar

Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:

- VKM nr. 248, datë 10.04.1998, “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre” i ndryshuar;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar;
- Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237, datë 16.07.2015, “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 26, datë 27.09.2019, “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”;

Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave lokale” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare” i ndryshuar;
- VKM nr. 170, datë 25.04.2002, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënieve e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre” i ndryshuar;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;
- Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë” i ndryshuar;
- VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar.

**6. Standardet e auditimit:**

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”;
- INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;

- INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.;
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.;
- Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

**7. Metoda e auditimit:** Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Në gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampionëve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin<sup>1</sup>:

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerësojnë si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

*Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:*

1. Kontrolli aritmetik:

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve);

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar;

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj.. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt;

4. Kontrolli i vlerësimit:

---

<sup>1</sup> ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre;

#### 5. Konfirmim nga të tretët:

Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër;

#### 6. Kontrolli sipas një treguesi:

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.,.

- Verifikimi i transaksioneve është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- Intervistimi është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- Raporte dhe informacione janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

**8. Dokumentimi i auditimit:** Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme.

Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, evidencave të mbledhura u hartua Projekt Raporti i Auditimit i cili u dërgua Subjektit me shkresën nr. 974/4 prot., datë 29.12.2025. Pas shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, të ardhura me shkresën nr. 10576/12, datë 15.01.2026 të protokolluara në KLSH nr. 974/5, datë 19.01.2026, nga grupi i auditimit të KLSH-së, u përgatit ky Raport Përfundimtar i Auditimit dhe Opinioni i Audituesit të Jashtëm Publik. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

### **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

#### **1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Korçë”:**

Korça kufizohet në veri me Bashkinë Maliq, në lindje me Bashkinë Devoll, në perëndim me Bashkinë Skrapar, ndërsa në jug me Bashkinë Kolonjë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Korçës. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 805.99 km<sup>2</sup>. Bashkisë së Korçës iu bashkëngjiten disa zona rurale të cilat merren me bujqësi dhe blegtori, por edhe disa prej fshatrave turistike më të spikatur. Qyteti ka një ekonomi të konsoliduar dhe biznese të shumta, por rritja e numrit të popullsisë si pasojë e zhvendosjes së banorëve nga zonat rurale ka sjellë edhe rritje të numrit të personave të papunë duke ngritur domosdoshmërinë e gjetjes së zgjidhjeve për punësim dhe kualifikimin e këtyre personave për profile të ndryshme. Në zonat rurale janë zhvilluar nga njëra

anë bujqësia dhe pemëtaria, dhe nga ana tjetër turizmi malor ku banorët kanë vetë-siguruar mënyrën e organizimit të ambienteve dhe kuzhinës por edhe aktivitetëve dimërore si një atraksion për turistët. Zonat më të thella si Lekasi dhe Vithkuqi për shkak të klimës së ashpër dhe izolimit të përvitshëm në dimër kanë pësuar zhvendosje masive të popullsisë çka ka minimizuar edhe shërbimet për pjesën e mbetur të banorëve duke nisur nga arsimi, mjekësia, infrastruktura, transporti, etj. Ndër projektet më të rëndësishme në qytetin e Korçës është ai i Pazarit të Korçës, investimi kolosal i të cilit ka në fokus rikthimin e një elementi autentik kulturor, ruajtjen e origjinalitetit të pazarit shekullor të Korçës dhe kthimin e tij në një destinacion turistik. Projektet për rimodelimin e Parkut të qytetit, sheshit para teatrit dhe rrugës Gjon Buzuku janë 3 projekte të tjera të rëndësishme për qytetin.<sup>2</sup>

## **2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.**

### **2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik (viti 2024):**

**2.1.1.** Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Korçë, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i Kontrollit”, “Menaxhimi i Riskut”, “Aktivitetet e Kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, sipas përcaktimit të nenit 19, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Në zbatim të auditimit, u kërkua dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Baza rregullatore mbi të cilën ushtron funksionet e saj Bashkia e Korçë: Rregullorja e brendshme e miratuar, Rregullorja për sinjalizimin, planet mujore dhe vjetore të punës. etj.,.
2. Strukturën organizative dhe organigramën e institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi; dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
3. Shkresat për krijimin e grupeve të menaxhimit strategjik [GMS];
4. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre në një vit;
5. Regjistrin e riskut;
6. Raportet e monitorimit ku përfshihen edhe Deklarata e cilësisë dhe Pyetësori i vetëvlerësimit;
7. Plotësimi i pyetësorëve të KLSH për bashkinë e Korçë, dërguar me E-mail;
8. Nga auditimi i dokumentacionit të vene në dispozicion nga Bashkia e Korçë, në përgjigje të kërkesave të përshkuara më lart lidhur me MFK-në, grupi i auditimit rezulton me këto konstatime:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Korçë, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si:

- *Mjedisi i kontrollit*

---

<sup>2</sup> **Burimi:** <https://portavendore.al/bashkia-korce/>

- *Menaxhimi i riskut*
- *Aktivitetet e kontrollit*
- *Informimi dhe Komunikimi*
- *Monitorimi*”,

Në referim të nenit 19, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, “Për disa shtesa dhe ndryshime”, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijojnë dhe vlerësojnë sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri-tjetrin.

- Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK-së nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e MFK-së nuk kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë.

Konkluzioni në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në mënyrë të detajuar argumentohen si më poshtë:

- Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

### **I. Komponenti “Mjedisi i Kontrollit”:**

**Parimi nr. 1:** “*Njësia publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike*”:

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, i cili siguron vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit. Mjedisi i kontrollit përmban:

- a) Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike;
- b) Politikat menaxheriale dhe stilin e punës;
- c) Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;
- ç) Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- d) Aftësitë profesionale të punonjësve.

Bashkia Korçë vepron mbi bazën e rregullores së brendshme miratuar me Vendimin nr. 142, datë 01.03.2021, dhe është ndryshuar/ka pasur shtesa me Urdhrin nr. 142/1 datë 11.07.2022, me Urdhrin nr. 142/2, nr. 1791/2 prot., datë 06.09.2024, dhe Urdhrin nr. 142/3, nr. 1791/3 prot., datë 24.10.2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Korçë”.

Në këtë dokument, janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për çdo strukturë të institucionit.

- Bashkia Korçë nuk ka të miratuar një Kod Etike të hartuar dhe miratuar si një dokument të veçantë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1/1, gërma “b”, VKM nr. 306, datë 13.06.2000, “Për disiplinën në shërbimin civil”.

### **1.2. Politika menaxheriale dhe stili i punës:**

Punësimi në Bashkinë Korçë bëhet në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 152/2013, “Për nënpunësin civil” i ndryshuar dhe Ligjit nr. 7961/1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr. 243/2015, i ndryshuar me VKM nr. 746/2018, Kreu I pikat 1 dhe 2. Kjo procedurë rregullohet nga Strukturat e Bashkisë Korçë.

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit sipas nenit 10 pika 1 e Ligjit nr. 152/2013, “Për nënpunësin civil” i ndryshuar dhe VKM nr. 243/2015 i ndryshuar Kreu II;

- Komiteti i Përhershëm i Pranimit në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM nr. 243/2015, i ndryshuar;

- Kryetari i Bashkisë në zbatim të nenit 64 pikat e, ë, f dhe g të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

- Për vitin 2024, Komiteti i Përhershëm i pranimit në Bashkinë Korçë është ngritur me Urdhrin e Kryetarit nr. 263, datë 26.03.2024, me nr. 2576 prot., datë 26.03.2024, konform VKM nr. 243/2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar me VKM nr. 746/2018, Kreu III pikat 2 dhe 3.

- Në rastin e shkeljes së etikës merret masa disiplinore “vërejtje” nga eprori direkt për nëpunësit civil dhe nga titullari për punonjësit administrativ. Masat disiplinore vendosen në dosje të veçantë ndërsa një kopje vendoset në dosjen e punonjësit deri në mbarimin e afatit të shuarjes së masës. Gjithashtu, masat disiplinore pasqyrohen në regjistrin elektronik të burimeve njerëzore HRMIS. Sipas ligjit për nëpunësin civil shkelja e kodit të etikës përben shkak për fillimin e procedurës disiplinore dhe marrja e masës vërejtje. Ka dy komisione disiplinore të cilat janë i pari eprori direkt për shkelje të lehta dhe i dyti për shkeljes më të rënda. Për sa i përket punonjësve administrativ masa merret nga titullari. Ndërkohë sipas Ligjit nr. 89/2022, “Për Policinë Bashkiake” për shkeljet e lehta masa disiplinore merret nga eprori ndërsa për shkelje me të rënda merret nga Komisioni Disiplinor.

- Sipas ligjit për nëpunësin civil shkelja e kodit të etikës përben shkak për fillimin e procedurës disiplinore dhe marrja e masës vërejtje. Për sa i përket punonjësve administrativ masa merret nga titullari. Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen.

- Në bazë të pyetësorit dërguar njësisive të menaxhimit, nuk ka një urdhër nga titullari i institucionit për njohjen dhe trajnimin e stafit me rregulloren dhe bazën ligjore në fuqi. Komunikimi për rregulloren e brendshme dhe dispozitat përkatëse për etikën dhe disiplinën është kryer nëpërmjet postës elektronike si dhe me paraqitjen në faqen zyrtare të bashkisë.

- Përsa i përket rregullave të etikës, monitorimi kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Burimeve Njerëzore nëpërmjet kontrolleve dhe vlerësimeve të performancës së punonjësve.

- Bashkia Korçë, me urdhër të titullarit nr. 654, datë 07.12.2016, ka miratuar njësinë përgjegjëse për sinjalizuesit, gjithashtu është miratuar dhe rregullorja për “Procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit, mbrojtjes së sinjalizuesit” dhe përcaktimin e mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit në zbatim të Ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, me Urdhër të titullarit nr. 1117, datë 19.12.2019. Ky urdhër është komunikuar në të gjitha Drejtoritë përkatëse dhe çdo Ndërmarrje në Varësi të Bashkisë Korçë. Aktualisht Njësia e Sinjalizimit të Brendshëm të përbërë nga 2 punonjës.

- Për vitin 2024 nuk ka raste të raportuara apo trajtuara nga kjo njësi.

**Parimi nr. 2:** “*Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA) Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje*”:

- Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë mbikëqyrëse mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

- Për vitin 2024, Bashkia Korçë ka hartuar dhe miratuar Planin e Veprimit për Kontrollin e Brendshëm, ku janë planifikuar aktivitetet e kontrollit, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse dhe lidhja me komponentin e sistemit.

Është përcaktuar përgjegjësia menaxheriale e drejtuesve të të gjitha strukturave të bashkisë të cilët janë përgjegjës dhe raportojnë e i japin llogari, sipas shkallës hierarkike, eprorit direkt deri tek Kryetari ose tek nëpunësit të cilëve kryetari u ka deleguar përgjegjësinë, për: “*Hartimin dhe monitorimin e planeve vjetore dhe periodike në përputhje me objektivat strategjike, afatmesme si dhe urdhrat dhe udhëzimet e Kryetarit, menaxhimin/administrimin e risqeve/problemeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata*

*drejtojnë (nëpërmjet identifikimit, vlerësimit dhe kontrollit periodik të zbatimit të masave për zvogëlimin e risqeve).*

- Për periudhën vitin 2024, janë hartuar raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për çdo 4-muaj, duke u paraqitur MF.

- Titullari i institucionit merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga raportet periodike të njërive të menaxhimit dhe institucione të pavarura si KLSH, si dhe nëpërmjet raporteve të auditimit nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm.

- Këshilli bashkiak me kompetencat e tij ushtron përgjegjësitë e mbikqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

**Parimi nr. 3:** *“Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”:*

- Eshhtë miratuar struktura për vitin 2024 me Urdhrin e Kryetarit nr. 2, datë 17.01.2024, “Për miratimin e strukturës të administratës së Bashkisë Korçë për vitin 2024” dhe Vendimin nr. 2, datë 17.01.2024, “Për miratimin e strukturës analitike të Bashkisë Korçë për vitin 2024”.

- Për vitin 2024, Bashkia Korçë ka miratuar Strukturën e saj me Vendimin 2 datë 17.01.2024, ku përcaktohet numri i përgjithshëm i punonjësve të Bashkisë prej 378 punonjësish, nga të cilët 22 staf politik (këshilltarë të Kryetarit) dhe administratorë të njërive, 184 pozicione pune të shërbimit civil, 172 pozicione pune të rregulluar me Kodin e Punës.

- Strukturat organizative janë shoqëruar me organigramën përkatëse. Organigrama si një paraqitje grafike e strukturës organizative, pasqyron një informacion të qartë dhe të kuptueshëm për të gjithë, mbi pozicionet, klasifikimin por edhe mbi numrin e personelit të planifikuar dhe atë faktik.

- Në vitin 2024 nuk ka opinion të AB, pasi nuk është audituar Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

- Nga auditimi rregullores së funksionimit së Bashkisë Korçë, në Rregulloren e saj konstatua se në një rast ka mbivendosje kompetencash.

- Në pikën **76.6** të Rregullores, ku përshkruhet përberja e strukturës **Spektori i Inspektimit dhe Mbrojtjes së Pyjeve**, si dhe përgjegjësitë dhe detyrat e këtij sektori së bashku me punonjësit e saj, vihet re një mbivendosje e detyrave dhe kompetencave të këtij sektori, duke qenë se detyrat e specialistit janë po të njëjtat me ato të përgjegjësit të sektorit. Këto dy pozicione kanë përgjegjësi e detyra të njëjta me njëra tjetrën dhe nuk përshtaten me linjën vertikale të hierarkisë dhe procesit të punës. Në kundërshtim me Ligjin 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni.20 pika 1,2 gërma c), ku përcaktohet se: 1. Titullarët e njërive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.

2. Mjedisi i kontrollit përmban:

c) strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;

-Bashkia Korçë nuk ka një plan strategjik për veprimtarinë vjetore ose të viteve në vijim.

- Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit, por është pjesë e rregullores së brendshme.

**Parimi nr. 4:** *“Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”:*

Ky parim vlerëson angazhimin e njërive publike për të krijuar dhe vlerësuar efektivitetin e politikave dhe procedurave të përputhshmërisë si dhe adresimin e çdo mangësie të evidentuar. Gjithashtu, nëpërmjet këtij parimi vlerësohet kapaciteti i njësive për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësisë.

Punësimi në Bashkinë e Korçë bëhet në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe Ligjit nr. 7961/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr. 243/2015, i ndryshuar me VKM nr. 746/2018, Kreu I pika 1, 2. Kjo procedurë rregullohet nga Strukturat e Bashkisë së Korçë:

- Sektori i Burimeve Njerëzore [SBNJ] është përgjegjëse për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit sipas nenit 10 pika 1 e Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe VKM nr. 243/2015, i ndryshuar Kreu II;
- Komiteti i Përhershëm i Pranimit [KPP] në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM nr. 243/2015 i ndryshuar;
- Kryetari i Bashkisë në zbatim të nenit 64 pika e, ë, f, g të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

***Politikat dhe praktikat e burimeve njerëzore:***

Strukturat përgjegjëse të Bashkisë së Korçë hartojnë në fillim të çdo viti Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil duke zbatuar Ligjin nr.152/2015 “Për nëpunësin civil” neni 18, VKM nr. 108/2014, “Për plani vjetor të pranimit në shërbimin civil”, VKB “Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të tyre” si dhe Vendimeve të Kryetarit “Për miratimin e strukturave organizative e analitike të Bashkisë Korçë” për çdo vit ushtrimor.

Plani vjetor i punësimit për vitin 2024 është miratuar me VKB nr. 10, datë 25.01.2024, “Për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për institucionin e Bashkisë Korçë për vitin 2024”. Në këtë plan janë planifikuar për shpallje të vendeve vakante 79 vënde pune të kategorizuara si vijon:

Një vend vakant për nëpunës të nivelit të lartë drejtues (drejtor drejtorie të përgjithshme), shtatë vend vakante për nëpunës të nivelit të mesëm drejtues (drejtor Drejtorie), pesëmbëdhjetë vende vakante për nëpunës të nivelit të ulët drejtues (Përgjegjës Sektori), pesëdhjetë e gjashtë vënde vakante për nëpunës të nivelit ekzekutiv (specialistë). Edhe pse shpallen vende vakante, nuk ka pasur numër të madh kandidatësh ose nuk kanë plotësuar kërkesat e kërkuara në shpallje dhe shpesh herë shpalljet kanë përfunduar pa kandidatët fitues. Për vitin 2024 janë kryer 35 konkurse nga të cilat janë emëruar 24 punonjës, ose 30.3% e planit dhe nevojave të institucionit.

- Në Bashkinë Korçë është hartuar e miratuar Harta e Proceseve të punës e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve njerëzore.

- Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, bashkia Korçë për vitin 2024, nuk ka pasur një plan program trajnimi, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Planifikimi është plotësuar vetëm në muajin tetor të vitit 2024 ku me shkresë nr. 9761/1 prot., datë 30.10.2024, i është dërguar Shkollës së Administratës Publike një tabelë përmbledhëse me 40 (dyzet) emrat e punonjësve (Nëpunës Civil), të gjitha kategorive dhe nevojat për trajnim për vitin 2025 në fushat ku ata janë të punësuar.

- Nëpunësi Autorizues dhe struktura përgjegjëse e Bashkisë Korçë (DBNJ), nuk kanë hartuar dhe miratuar plane dhe programe vjetore efektive për trajnimin e detyrueshëm të punonjësve, në zgjerimin e njohurive të tyre për proceset e punës dhe të aftësive për t’i kryer me efikasitet ato dhe kryesisht për njohjen nga stafi dhe menaxherët e njësisë mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, në moszbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 64, pika h, Ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kapitulli III, pika 3.1.

**Parimi nr. 5:** “Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”:

- Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësive dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm.

- Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.

- Për vitin 2024, Titullari i Bashkisë, me shkresën nr. 585 prot., datë 29.01.2024, ka nxjerrë Urdhrin

nr. 76, i ndryshuar për shkak të ndryshimeve në strukturë urdhri i GMS pësoi ndryshime gjatë vitit 2024 me Urdhri nr. 268, datë 27.03.2024, dhe Urdhrin nr. 268/1, datë 06.09.2024, “Për Ngritjen e Grupit për Menaxhimin Strategjik (GMS)” dhe në pikën 2, krijimin e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP).

Grupi ka në përbërje 22 anëtarë dhe Kryetar grupi është Titullari i Bashkisë, ku sipas urdhrin rezulton:

Kryetar i Bashkisë (Kryetar i GMS);

Zv. Kryetar i Bashkisë (Kordinator i GMS);

Nëpunës Zbatues (Sekretar i GMS);

- Vlen të theksojmë se GMS luan një rol kyç për sa i takon integritetin të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.

- Për sa i përket krijimit të Ekipeve për Menaxhimin e Programeve, anëtarët janë përgjegjës dhe angazhohen në përgatitjen dhe realizimin e programeve/aktiviteteve/projekteve në bazë të drejtimeve përkatëse të programit dhe japin llogari nga pikëpamja funksionale tek drejtuesi i programit. Bazuar në Urdhrin nr. 77, janë krijuar 9 ekipe për menaxhimin e programeve si më poshtë:

1. Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi;

2. Siguria Publike;

3. Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik;

4. Mrojtja e Mjedisit;

5. Shërbimet Publike Vendore;

6. Kultura, Sporti dhe Argëtimi;

7. Arsimi Bazë dhe Parashkollor;

8. Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm;

9. Përkujdesja sociale.

- Në zbatim të nenit 24, të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” i ndryshuar; Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Udhëzimin e MF nr. 23, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësisë të Qeverisjes Vendore”, është ngritur GMS ku është miratuar “Kalendari i Programit Buxhetor Afatmesëm” 2024-2026 dhe i buxhetit vjetor 2024, i miratuar me VKB nr. 1, datë 16.01.2024, dhe konfirmuar nga institucioni i Prefekti të Qarkut me shkesën me nr. 43/1 prot., datë 17.1.2024.

- Me VKB nr. 167, datë 29.12.2023, është miratuar Buxheti vjetor 2024 dhe PBA 2024-2026 i Bashkisë Korçë, dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Koçë me shkresën nr. 11/1 prot., datë 09.01.2024.

#### **Raportet e Monitorimit 2024:**

Për vitin 2024, janë përgatitur 3 raporte 4-mujore për procesin e buxhetit të detajuara si më poshtë:

a) “Raporti i monitorimit janar-prill 2024” me e-mail datë 17.05.2024;

b) “Raporti i monitorimit janar-gusht 2024” me e-mail datë 25.09.2024;

c) “Raporti i monitorimit janar-dhjetor 2024, dërguar në MF me shkresën nr. 1846, datë 24.02.2025.

- Me VKB nr. 52, datë 29.05.2025, është miratuar Raporti i konsoliduar për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të Bashkisë Korçë për vitin 2024, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Koçë me shkresën nr. 52 prot., datë 04.06.2025.

Dërguar në MF me shkresën me nr. 5340 prot., datë 03.06.2025, si dhe deklarata e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe raporte për funksionimin e kontrollit të brendshëm. Lidhur

me përbërjen e GMS, në përgjithësi ajo është sipas përcaktimit të bërë në pikën 30, të Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2016, “Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore”, ku drejtuesi i grupit është Kryetari i Bashkisë, si dhe ka përfaqësues nga të gjitha drejtoritë dhe sektorët e Bashkisë.

- Nga auditimi i veprimtarisë së Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) konstatohet se Bashkia Korçë nuk ka miratuar plan pune vjetor lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik në kundërshtim me Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2.4.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion Grupit të Auditimit konstatohet se për aktivitetin vjetor të GMS janë mbajtur vetëm 2 procesverbale nr. 2592 prot., datë 04.04.2024, dhe nr. 2592/2 prot., datë 09.09.2024, në të cilat janë evidentuar çështjet për diskutim. Në këto dy mbledhje nuk është konkluduar me vendime.

Nga auditimi i raporteve të monitorimit të raportuara në Ministri të Financave theksohet se të dhënat janë të konfirmuara nga GMS, ndërkohë që në dosje të GMS mungojnë procesverbale të mbledhjeve ku janë diskutuar të dhënat për raportet e monitorimit dhe vendimarrjet e GMS lidhur me këto të dhëna.

## **II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”:**

**Parimin nr. 6:** “Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre”:

- Në institucion është caktuar koordinatori i riskut, bazuar në nenin 10 të ligjit për MFK. Me urdhër të kryetarit të bashkisë nr. 134, datë 20.2.2024, “Për menaxhimin dhe koordinimin e riskut në Bashkinë Korçë”.

- Ka një regjistër risku që përfshin risqet më të rëndësishme të lidhura me objektivat e bashkisë.

- Çdo Drejtori ka hartuar dhe miratuar plan-veprimi vjetore operationale, me aktivitete, afate konkrete për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme të parashikuara në PBA. Gjithashtu në raportin e monitorimit janë identifikuar të gjithë treguesit e performancës.

**Parimin nr. 7:** “Njësia publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”:

- Në Bashkinë Korçë titullari nuk ka të miratuar strategjinë e menaxhimit të riskut, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 15, datë 20.07.2016, pika 3.2.3, si dhe në kundërshtim me në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre. Këto mangësi janë në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, ku citohet se: “Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut”.

- Rregjistri i Riskut është hartuar nga GMS duke marrë në konsideratë vetëm raportet e auditimit të kontrollit të brendshëm, dhe kontrollit të jashtëm (Kontrolli i Lartë i Shtetit), drejtoritë dhe sektorët e Bashkisë Korçë nuk kanë identifikuar riskun që mbartin objektivat e përcaktuara, në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.2, “Menaxhimi i Riskut”.

- Përcaktimi i NA dhe NZ është bërë në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH”, si dhe Ligjit nr. 90, datë 27.09.2012, “Për organizimin e administratës shtetërore” si dhe janë njoftuar Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financës Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues plotësojnë kriteret e kërkuara nga ligji si: (kriteri i varësisë NA-NZ, kriteri i arsimimit dhe kriteri i nivelit menaxherial.

### III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”:

➤ *Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli:*

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, krahas detyrave, janë të identifikuara edhe proceset e punës.

- Konstatohet se urdhër shpenzimet nënshkruhen nga nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues.

- Nga auditimi i dokumentacionit që u vu në dispozicion lidhur me takimet e detyrueshme vjetore të GMS, ka vetëm dy mledhje të dokumentuara, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10296/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe “Manualit të Menaxhimit financiar dhe kontrollin” përcaktohet se “Grupi për Menaxhimin Strategjik duhet të mbliidhet të paktën katër herë në vit. Vendimet e Grupit duhet të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive duke patur në vëmendje interesin publik dhe në përputhje me standardet etike të sektorit publik. Vendimet e Grupit duhet të pasqyrohen në dokumente dhe t’i vihen në dispozicion menaxhimit të njësisë”

- Bashkia Korçë ka hartuar “Plani i Veprimit për Zhvillimin e Kontrollit të Brendshëm” me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat si dhe qëllimet do të arrihen) dhe me shkresën nr. 2014 prot., datë 27.02.2025, i është përcjellë Njësisë Qëndrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe Financiare (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike, hartimi dhe regjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit të Financës, ndërsa Autorizimi i pagesës nga NA.

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve.

- Ka një regjistër të parashikimit të prokurimeve i cili përditesohet gjatëvitit në përputhje me ndryshimet e fondeve në dispozicion të bashkisë. Regjistri i parashikimit të prokurimeve të vitit 2024 dërguar degës të thesarit me shkresën nr. 669 prot., datë 24.01.2024. Regjistri përditesohet gjatë vitit në përputhje me ndryshimet e fondeve në dispozicion të njësisë.

- Dokumentacionet të ndodhura pranë arkivit të institucionit ruhen, përdoren dhe arkivohen sipas Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat” dhe nenit 25 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë. Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Korçë është miratuar:

1. Pasqyra emërtuese e çeljes së dosjeve për vitin 2024 me nr. 41 prot., datë 04.01.2024;

2. Vendimi nr. 1, datë 04.01.2024, “Për ngritjen e Komisionit të Ekspertizës”;

3. Vendimi nr. 2, datë 04.01.2024, “Për njësimin e dokumentit administrativ”;

4. Vendimi nr. 3, datë 04.01.2024, “Për sigurinë dhe përgjegjësinë për materialet arkivore” Komisioni i Ekspertizës me nr. 40 prot., datë 04.01.2024, ka përpiluar Listën Konkrete me afatet e ruajtjes së dokumentave.

- Aktivitetet e rëndësishme dhe aktivitetet afatgjata ruhen nga përdorimi i paautorizuar. Për ruajtjen e tyre zbatohen rregullat e përcaktuara në kërkesat ligjore sipas VKB nr. 70, datë 29.06.2018, “Për menaxhimin e aktiveve dhe menaxhimin e riskut të aktive të Bashkisë Korçë”.

- Në Rregulloren e Brendshme për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditesohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitetet afatgjata dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e Zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësi material.

- Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Korçë.

- Bashkia Korçë në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për cdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia.

- Titullari i Bashkisë Korçë nuk ka miratuar e arkivuar gjurmën e auditimit. Gjurma e auditimit" përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve. Kjo bie në kundërshtim me nenin 16 pika 2 të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

**Parimin nr. 11:** "Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë":

- Njësia publike ka sistem informatik për taksat dhe tarifatat vendore. Gjithashtu Bashkia përdor edhe Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV).

- Drejtoritë e tjera nuk punojnë me aplikacione dhe programe të posaçme për menaxhimin e të dhënave, por vetëm me programet Word/Excel, duke krijuar hapësirë për cënimin e integritetit të dhënave që institucioni menaxhon dhe përpunon.

Institucioni ka procedurë për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë së punës nëpërmjet një sistemi rezervë (back-up) TI të përshtatshëm, plan rikuperimi nga fatkeqësitë të testuar në praktikë. Për këtë është një server në të cilin ruhen të dhënat e kompjuterave me të dhëna të rëndësishme, ruajtja e të dhënave në i-cloud. Planet e emergjencave janë vënë në zbatim në mënyrë testuese pasi deri tani nuk ka pasur asnjë situatë emergjence reale.

- Ekzistojnë procedurë të mirë organizuara për sigurinë e sistemit TI që aktivitetet e kompjuterave dhe të dhënat të ruhen nga ndërhyrjet e paautorizuara (ndryshohen fjalëkalimet rregullisht për user-at të cilët janë pjesë e Active Directori-së të hostuar në një server të posaçem, Bashkia ka një fireëall të saj fizik i cili bën filtrimin e të gjithë trafikut hyrës dhe dalës të të dhënave në internet dhe entranet dhe gjithashtu filtrimi bëhet edhe nëpërmjet mikrotikut të Bashkisë. Secili user ka kredencialet e tij gjë e cila garanton një hyrje të kufizuar në të dhënat e tyre, ndërsa serverat kanë masat e sigurisë të nevojshme për ruajtjen dhe përdorimin e sigurtë të të dhënave që ruhen në to.

- Institucioni ka një sistem rezervë (back-up) TI të përshtatshëm, plan rikuperimi nga fatkeqësitë të testuar në praktikë. Për këtë është një server në të cilin ruhen të dhënat e kompjuterave me të dhëna të rëndësishme, ruajtja e të dhënave në i-cloud.

**Parimin 12:** "Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave":

- Bazuar në Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018, "Procedurat e përgatitjes, paraqitjes, dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar.

- Ekzistojnë procedurë kontrolli lidhur me:

a) integritetin e të dhënave financiare, konkretisht detyrimi për rakordimet mujore të llogarive (arkë, thesar, bankë-nëse ka); rakordimin dhe pastrimin e llogarive kontabël pezull dhe të paradhënëve.

b) sigurinë e të dhënave financiare si qasjen në të dhënat kontabël (kush ka të drejtë vetëm leximin e të dhënave dhe kush dhe kur regjistron/ndryshon të dhënat)

c) ka gjurmë auditimi/punonjës/njësi të caktuar me verifikimin e integritetit të dhënave financiare. Bashkia është bazuar në Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetqeverisjes vendore" si dhe në udhëzime standarte plotësuese.

**IV. Komponenti: "Informimi dhe Komunikimi":**

**Parimin 13:** Bashkia Korçë disponon faqen e saj të web-it <https://bashkiakorçe.gov.al/>

Në këtë web faqe pasqyrohet aktiviteti i saj si Rregullorja e Brendshme, broshura, planet e performancës, projekte të brendshme dhe të huaja, bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit,

aktivitete, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, projekt buxheti vjetor, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve. Janë janë përditësuar raportet periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin e prokurimeve, raporte të auditimit, institucionet e varësisë, nuk përditësohet informacioni mbi ndryshimet në strukturën e bashkisë, paketat fiskale. Çdo drejtori ka e-mail-in zyrtar dhe është e përcaktuar apo menaxhohet nga Drejtori i Drejtorisë. Komunikimi me publikun, ankesat dhe kërkesat për informacion menaxhohen nga organet e parashikuara në Rregulloren e brendshme.

**Parimin 14:** *“Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm”:*

- Të gjithë punonjësit kanë mundësinë e përdorimit të emailit zyrtar.
- Kryetari i Bashkisë dhe drejtuesit e institucioneve të vartësisë informohen nga NZ për shpenzimet buxhetore krahasuar me planifikimin e tyre. Çdo drejtues programi, titullar institucioni, informohet në vazhdim për nivelin e shpenzimeve në total e për çdo program, njeh buxhetin e planifikuar që ka në përgjegjësi.
- Punonjësit dinë se ku t'i raportojnë parregullsitë dhe problemet.
- Ka një komunikim të rregullt me institucionet e tjera jashtë bashkisë.

**Parimi nr. 15:** *“Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm”:*

- Sipas këtij parimi, njësia publike komunikon me palët e jashtme lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.
- Bashkia Korçë realizon konsultime publike me banorët sipas kalendarit të konsultimeve, i cili është publik në faqen e Bashkisë, si "Buxhetimi me Pjesëmarrje". Në të diskutohen projektbuxheti dhe Paketa Fiskale, konsultime me përfaqësues të biznesit, organizata jo qeveritare, apo grupe të interesit. Kjo sjell përmirësimin e strategjisë së komunikimit dhe përfitimin e një feedbacku të qartë në lidhje me kërkesat e komunitetit. Gjithashtu bashkia realizon sondazhe online të cilat mund të plotësohen lehtësisht nga qytetarët me qëllim marrjen e opinioneve dhe reagimeve të tyre.
- Informacioni i marrë ndihmon të përputhen nevojat njerëzore me burimet publike, duke reflektuar prioritetet reale të banorëve.

Në faqen zyrtare të web-it [www.bashkiakorçe.gov.al](http://www.bashkiakorçe.gov.al), rubrika “Transparenca” gjenden të publikuara të gjitha informacionet e përmendura si pjesë e kategorisë “Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare”. Ky informacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe i përditësuar.

**V. Komponenti: “Monitorimi dhe Raportimi”:**

**Parimin 16:** *“Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”:*

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin bashkisë. Raportimet e drejtuesve të sektorëve dhe drejtorive bëhen në shkresa dhe në mënyrë verbale drejtuar eprorëve.
- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili duhet hartohet çdo 4 muaj, dhe është dorëzuar brenda afateve në MF (Ministrinë e Financave).
- Procesi i vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm realizohet nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit të menaxherëve e strukturave, hartimit e deklaratës mbi cilësinë e kontrollit të brendshëm, si dhe me anë të njësisë të auditimit të brendshëm, e cila vepron sipas një plani vjetor dhe strategjik të miratuar nga titullari i institucionit.

- Bashkia Korçë lidhur me pyetëtorin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë, ka raportuar në MF për vlerësimin e sistemeve për vitin 2024.

-Raporti i Cilësisë së Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm paraqet në mënyrë të përmbledhur problematikat në 5 komponentët e MFK dhe është deri diku në përputhje me problematikat e evidentuara në këtë akt konstatimi.

**Parimi nr. 17:** *“Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe/ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm”*:

- Drejtuesit e nivelit të lartë raportojnë për aktivitetin e strukturave të tyre me raporte mujore e katërmujore. Raportime joformale bëhen çdo javë.

- Nuk ka procedurë të shkruar në lidhje me frekuencën e raportimit, por bazohen në udhëzimet e MF.

- Raportet përfundimtare për çdo angazhim të AB të kryer në vitin 2024, kanë rekomandime specifike për sistemin e kontrollit të brendshëm, duke filluar nga përditësimi i rregullores, menaxhimi i riskut, aktivitet e kontrollit, sistemin e informimit e komunikimit dhe monitorimin. Të gjitha rekomandimet janë pasqyruar në raportin vjetor të AB për vitin 2024, të miratuar nga kryetari i bashkisë dhe të dërguar në DHAB në MF, me shkresën nr. 466/1 prot., datë 13.02.2025. Në totalin e rekomandimeve të dhëna nga AB, rekomandimet specifike për sistemin e KB zënë 30%. Ndërsa realizimi i tyre deri sot është 23%. Njësia e AB ka hartuar e miratuar tek kryetari i bashkisë planin vjetor e strategjik 2024-2026. Urdhëri i kryetarit nr. 1082, datë 18.10.2023, është dokumenti përkatës. Vlerësimi i riskut të AB është pjese e dosjes për çdo angazhim dhe në planin strategjik paraqitet në aneksin nr.1. Në raportin vjetor të AB për vitin 2024, në kapitullin IV Rezultatet e veprimtarisë së AB, në pikën Vlerësimi i sistemeve të KB, jepet dhe Opinioni i përgjithshëm mbi efektivitetin e sistemit të KB.

AB ndërmerr auditime për sistemin e pagave të njësisë, në bazë të përcaktimit të riskut çdo vit për këtë fushë.

**Parimi nr. 18:** *“Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”*:

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve ka raportime për mangësi të çështjeve të kontrollit të brendshëm ku janë paraqitur dhe si pjesë e raportit vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. S. F.** Kryetar i Bashkisë Korçë, **znj. V. Z.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, **znj. A. Q.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Juridike dhe Burimeve Njerëzore dhe **z. K. K.** Nënkryetar i Bashkisë Korçë.

### **2.1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm:**

Për vitin 2024, DAB Drejtoria e Auditit të Brendshëm funksionon në nivel drejtorie dhe është miratuar me Vendim nr. 2, datë 17.01.2024, “Për miratimin e strukturës analitike të administratës së Bashkisë Korçë”. Detyra e kësaj strukture është të programojë, organizojë dhe kryejë auditime të brendshme me miratim të Kryetarit të Bashkisë në strukturat e varësisë së drejtpërdrejtë të Bashkisë Korçë, për të konstatuar dhe evidentuar shkallën e zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, bazuar në Manualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik.

- Drejtoria e Auditit të Brendshëm, në Bashkinë Korçë për vitin 2024 ka funksionuar me 1 (një) Drejtor dhe 3 (tre) Specialistë, sipas strukturës organizative të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Korçë. Për vitin 2024, Drejtor i DAB për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, ka qenë znj. A T. Përbërja e DAB, për vitin objekt auditimi paraqitet si më poshtë:

Nr.	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime të vijueshme 2024
1	A. T.	Drejtor	21.06.2007	Financë	37	23	2005-2006	40 orë
2	E. H.	Auditues	04.08.2015	Ekonomist	38	9.5	2016-2017	40 orë
3	B. S.	Auditues	01.07.2021	Kontabilitet	16.5	3.5	2022-2023	40 orë
4	A. R.	Auditues	14.11.2024	Kontabilitet & Audit	4	1.5 muaj	paçertifikuar	Jo

- Përsa i takon trajnimeve periodike, që duhet të realizojë stafi i audituesve që janë pjesë e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, në Bashkinë Korçë, bazuar në të dhënat e regjistrit të trajnimit të vazhdueshëm profesional të audituesve të brendshëm të sektorit publik për vitin 2024, vihet re se janë ndjekur trajnime të vijueshme profesionale nga 3 (tre) punonjës të DAB.

Nga auditimi rezultoi se:

- Për sa trajtuar më sipër konstatohet se struktura e DAB Bashkia Korçë nuk është e plotësuar me numrin maksimal të punonjësve sipas vendimit të sipërpërmendur konkretisht për 1 pozicion specialist auditi.

Nga auditimi i dosjeve të personelit të DAB (*Drejtoria e Auditit të Brendshëm*), u konstatua se: Specialistja e auditit të brendshëm znj. A. R. është emëruar në këtë pozicion pune me shkresë nr. 10874 prot., datë 14.11.2024, Vendim nr. 52, i miratuar nga Kryetari i Bashkisë Korçë. Gjatë auditimit të dosjeve të auditimit të kryera nga NjAB Bashkia Korçë gjatë vitit 2024, e konkretisht **“Auditim mbi detyrimet e prapambetura”** është konstatuar se: Në dosjen e auditimit në dokumentet standarte, formati standart. 1, “Autorizim për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim” i plotësuar më datë 01.11.2024, emri i punonjësës znj. A. R. evidentohet e planifikuar si anëtare e grupit të auditimit.

- Po ashtu konstatohet se znj. A. R. të ketë firmosur po më datë 01.11.2024, dhe formatin standart. 2, deklaratën e konfliktit të interesit të Auditit të Brendshëm dhe dokumentin format standart. 3, “Njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit”. Dokumentacion drejtuar Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Financës, Buxhetit dhe MFK, me nr. 5 prot., datë 04.11.2024, (*protokoll i brendshëm*), me kundërfirmë miratimi të Drejtorit të DAB, znj. A. T.. Grupi i auditimit duke vlerësuar dokumentacionin e sipërcituar konstaton se: znj. A. R., referuar shkresës me nr. 5881 prot., Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Korçë, nga data 05.07.2024, deri më datë 14.11.2024, ka ushtruar detyrën e specialistes së fushave të ndryshme, pjesë e strukturës shtesë së bashkisë Korçë në *Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës*. Planifikimi i punonjësës znj. A. R. nga drejtuesi i DAB si dhe nga pranimi i vet nëpunësës pa qenë e emëruar si pjesë e kësaj strukture si pjesë e grupit të auditimit, është në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në pikën 1 të nenit 10, shkronjën “a” të nenit 12, shkronjën “a” të nenit 14 në Ligjin nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** Kryetari i Bashkisë Korçë **z. S. F**, si dhe Drejtuesi i NjAB Bashkia Korçë, **znj. A. T.**

Gjithashtu nga vetë punonjësi, znj. A. R. duhet të ishte refuzuar pranimi për angazhimin në shërbimin e auditimit, në kushtet kur nuk ka qenë pjesë e NjAB Bashkia Korçë. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 3, të nenit 43, në Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

**Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** **znj. A. R.** specialiste e NjAB Bashkia Korçë

### **2.1.2. Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm:**

**1.** Karta e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Korçë është miratuar nga Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr. 257, datë 15.04.2021, dhe është dërguar në DHAB në MF me shkresën nr. 3135 prot.,

data 15.04.2021, në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli II, pika 2.5.

2. Plani Strategjik është miratuar nga kryetari i bashkisë me Urdhërin nr. 1082, datë 18.10.2023, dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm Ministria e Financave dhe Ekonomisë për vitet 2024-2026 me shkresë nr. 725/1 prot., datë 18.10.2023, në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.2. Referuar shkresës me nr. 9533 prot., datë 16.10.2024, “Për një ndryshim në planin e auditimit të brendshëm në bashkinë Korçë për vitin 2024, janë synuar të realizohen 5 (pesë) auditime nga 7 (shtatë) të planifikuara. Arsyetar se një nga specialistët është me leje lindje dhe mungesa e plotësimit të strukturës me një specialist.

- Duke u bazuar në planin vjetor për vitin 2024, për auditimet e parashikuara nga DAB, kanë qenë objekt auditimi subjektet si më poshtë:

*Planifikimi dhe realizimi i auditimeve gjatë vitit 2024*

Nr.	Subjekte të Audituar 2024			Niveli i Riskut
	Planifikuar 2024	Realizuar 2024		
1	Zbatimi i rekomandimeve për fushat e audituara në vitin e mëparshëm	Verifikim i zbatimit të rekomandimeve në subjektet e audituara në vitin 2023		I lartë
2	Bashkia Drejtoria e Financës	Bashkia - Financa për detyrimet e prapambetura		I lartë
3	Bashkia Sektori i Integritit Europian	Bashkia- projekti SEMP, financiar nga fondet e Konfederatës Zvicerane.		I lartë
4	Qendra e Artit e Kulturës (BTK)	Qendra e Artit e Kulturës (B.T.K.)		I lartë
5	Bashkia-Shërbimet në njësitë administrative, Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskopojë, Voskop, Vithkuq dhe Lekas	Jo, zhvendosur në vitin e ardhshëm		I lartë
6	Bashkia-Shërbimet në Rajonet nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3	Jo, zhvendosur në vitin e ardhshëm		I lartë
7	Klubi Shumësportësh Skënderbeu	Klubi Shumësportësh Skënderbeu		I mesëm

3. Raporti vjetor i veprimtarisë së AB për vitin 2024 me pasqyrat shoqëruese, është dërguar në DHAB në MF me shkresën nr. 466/1 prot., datë 13.02.2025. Dokumentacioni është dërguar në afat shoqëruar edhe me pjesën përshkruese të raportit i përgatitur sipas standardeve që përcakton Manuali i Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.6.

4. Struktura e Projekt Raporteve dhe e Raporteve Përfundimtare të Auditimit për vitin 2024 është hartuar e plotësuar sipas standardit të vendosur në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, pika 4.1.12, Hapi 11.

5. Dosjet koherente të DAB për auditimet e realizuara për periudhën objekt auditimi në përgjithësi janë mbajtur të plotësuar në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VI, në to është i përfshirë i gjithë informacioni dhe dokumentet e nevojshme. Pasqyra e rekomandimeve të dhëna nga auditimet e realizuara nga DAB për vitin 2024, si dhe faza e zbatueshmërisë së tyre paraqitet në mënyrë të hollësishme si më poshtë:

Nr.	Subjekti Audituar	Rek. të dhëna në vitin 2024	STATUSI I REKOMANDIMEVE								Audituesit
			Rekomandim i dhënë	Rekomandim i pranuar	Rekomandim i zbatuar	Në proces zbatimi	Rekomandime të ndërmarrura në vlerësimin e	Rekomandime të kontaktit	Rekomandime të realizuara	Rekomandime për realizim	
1	Klubi Shumësportësh Skënderbeu	31	31	31	17	14	22	0	7	2	A. T. + E. H.
2	Verifikim i zbatimit të rekomandimeve në subjektet e audituara në vitin 2023	33	33	33		33				0	E. H. + A. T.

3	Bashkia- projekti SEMP, financiar nga fondet e Konfederatës Zvicerane.	6	6	6	3	3	0	3	0	E. H. + B. K.	
4	Qendra e Artit e Kulturës	25	25	25	10	15	17	0	8	0	A. T. + E. H. + B. K.
5	Bashkia - Financa për detyrimet e prapambetura	1	1	1		1	1	0	0	0	E. H. + A. R.
<b>Totali</b>		<b>96=63+33</b>	<b>96</b>	<b>96</b>	<b>30</b>	<b>33+33</b>	<b>43</b>	<b>0</b>	<b>18</b>	<b>2</b>	

- Për vitin 2024 referuar planifikimit vjetor janë planifikuar për t'u kryer 7 auditime nga të cilat kanë përfunduar 5 auditime sipas planit vjetor i ndryshuar.

- Nga auditimi konstatohet se zbatimi i planit vjetor të përcaktuar nga DAB është kryer në masën 71%, si pasojë e menaxhimit jo efektiv të burimeve njerëzore dhe mangësive në personel.

- Parashikimi për vitin 2024 është mbështetur në zbatimin e Udhëzimit nr. 42, datë 27.10.2020, të Ministrisë të MFE "Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga AB në sektorin publik", orientimet e DHAB-së në MFE për vlerësimin e sistemit të detyrimeve financiare të prapambetura dhe vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve dhe operacioneve të menaxhimit të brendshëm në sektorin e Integritit Europian për projektet me fonde IPA, duke parashikuar angazhime auditimi për këto fusha. Duke ndjekur ecurinë e realizimit të planifikimit, në muajin tetor 2024 është bërë një rishikim i planifikimit i cili është miratuar nga kryetari i bashkisë në datë 04.10.2024. Rishikimi i planit vjetor është argumentuar me:

- Mungesën e një auditueseje për kryerjen e lejës së lindjes.
- Ndryshime të subjektit të audituar me kërkesë të kryetarit të bashkisë.
- Sugjerimin e DHAB për auditimin e projekteve me fonde të huaja.

Një kopje e rishikimit të planit vjetor 2024 i është dërguar DHAB në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 9533 prot., datë 16.10.2024.

- Për vitin 2024, janë dhënë gjithsej 96 rekomandime, nga të cilat, për përmirësimin e sistemit të prokurimeve e blerjeve janë propozuar 23 rekomandime, për përmirësimin e sistemit të pagesave janë propozuar 7 rekomandime, për përmirësimin e sistemit të të ardhurave janë propozuar 5 rekomandime, për përmirësimin e sistemit të administrimit të pronës e pasurisë janë propozuar 27 rekomandime dhe për përmirësimin e sistemeve të tjera janë propozuar 34 rekomandime. Nga 96 rekomandime gjithësej, 33 prej tyre i takojnë rekomandimeve të vitit 2023. Kështu për vitin 2024 mbeten vetëm 63 rekomandime të lëna.

*Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm:*

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të marra me zgjedhje, auditim i Qendra e Artit e Kulturës Bashkisë Korçë, Drejtoria e Financës për detyrimet e prapambetura dhe Klubi Shumësportësh Skënderbeu, u konstatua se:

- Në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 100, datë 25.10.2016.

- Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VI, "Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese", në përgjithësi programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve, dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e auditimit, drejtimet që do të ndiqen, dhe grupin e auditimit. Në përgjithësi referencat ligjore të vëna në programet e auditimit reflektojnë kuadrin ligjor në fuqi.

- Hartimi i Projekt Raportëve dhe Raportëve Përfundimtare është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit.

Për të 4 njësitë e vartësisë të audituara në vitet 2023-2024, në një nga pikat e programit është programuar: Auditimi i Sistemit të Administrimit të pronës dhe pasurisë ku përfshihen:

- Rregullat për dokumentimin dhe rregjistrimin e fondeve, vlerësim i dokumentacionit provizor për qarkullim AQ.
- Rregullat për kontabilizimin e aktiveve të institucionit, rregjistri i aktiveve.
- Vlerësim i pasqyrave financiare të njësisë vartëse.
- Vlerësimi i kontrollit periodik të aktiveve, pasqyrimi në inventarin vjetor.

Në vitin 2024 janë kryer auditime në dy njësi vartëse. Për gjetjet e konstatuara janë lënë rekomandimet përkatëse për auditimin e sistemit të pronës dhe pasurisë.

Për vitin 2024 nga DAB nuk është kryer angazhim auditimi për vlerësimin e raportimit financiar të bashkisë dhe ato të konsoliduara bashkë me njësitë e vartësisë.

### **Konkluzione:**

- Në dosjet e auditimit nuk janë konstatuar shpresa rikujtuese nga ana e drejtuesit të njësisë së auditimit drejtuar njësisve të menaxhimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Këto mangësi bien në kundërshtim me Kreun IV paragrafi 4.1.13.1 të Manualit për Auditimin e Brendshëm.
- Dosjet e auditimit të brendshëm të audituara gjatë vitit 2024 nuk ndjekin rregullat në arkivin e njësisë vendore në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, dhe nenin 19 pika 1 e “Normave Teknike Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”.
- Mos ndjekja e këtyre rregullave bazë nga DAB është në kundërshtim me parimet e MFK ku përshkruhen qartë rregulla dhe forma të gjurmës së auditimit ku përcaktojnë rradhën dhe ngjarjet e ndodhura gjatë një procesi.
- Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit, duke rënë në kundërshtim me paragrafin me Kreun 6, pika 6.3 të Manualit të Brendshëm të Auditimit.

**Për veprime dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. S. F. Kryetar i Bashkisë Korçë; znj. A. T. Drejtor i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm; znj. A. R, specialiste pranë Drejtorisë së Auditit të Brendshëm.**

### **2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2024, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

**2.3.1.** Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

**2.3.2.** Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

**2.3.3.** Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

U shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat Financiare individuale dhe të konsoliduara për vitin ushtrimor 2024;
- Ditarët e kontabilitetit për vitin ushtrimor 2024;
- Listë pagesat me zgjedhje për vitin ushtrimor 2024;
- Dokumentet e bankës dhe të arkës për vitin ushtrimor 2024;
- Aktet e rakordimit me degën e thesarit Korçë, për vitin ushtrimor 2024;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoritë e ngarkuara për administrimin e taksave dhe tarifave vendore sipas paketës fiskale të miratuar për vitin 2024.

Për auditimin mbi vlerësimin e raportimit financiar, është mbajtur Akt Konstatimi nr. 3, datë 14.11.2025, i cili synon arritjen në opinionin nëse pasqyrat financiare të Bashkisë Korçë për vitin 2024 japin një paraqitje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe

fluksit të parasë, grupi i auditimit është mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht si më poshtë:

**Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:**

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

Në vijim, grupi i auditimit ka marrë në shqyrtim dokumentacionin përkatës, pyetësorët e adresuar pranë institucionit si dhe informacionin e grumbulluar nga intervistat zhvilluar me stafin e ngarkuar për procesin e përgatitjes, verifikimit, miratimit dhe konsolidimit të pasqyrave financiare. Për të verifikuar nëse institucioni ka vendosur *masa të brendshme të dokumentuara (rregullore, deklarime, kontrole, rakordime, autorizime të dyfishta)* që sigurojnë se personat përgjegjës për raportimin financiar nuk ndikohen nga interesa personale gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare dhe me qëllim testimin nëse institucioni ka përmbushur *detyrimin ligjor për parandalim, jo vetëm reagim pas ngjarjes, nga grupi i auditimit u kërkua nga ky institucion të vihet në dispozicion informacion, konkretisht si më poshtë:*

**Mbi pavarësinë e NjAB në procesin e raportimit financiar:**

Dokumentacioni që provon ushtrimin e funksioneve të NjAB mbi proceset e raportimit financiar (*përgatitje, verifikim, miratim, konsolidim*) për vitin 2024 (p.sh. programe auditimi, raporte, memo, rekomandime, gjurmen e auditimit);

*Evidencë e vlerësimeve të kryera mbi raportimin financiar të njërive vartëse, nëse janë kryer kontrole prej NjAB;*

*Nëse nuk janë kryer auditime mbi raportimin financiar të njërive vartëse, kërkohet vendimi zyrtar me arsyetimin për moskryerjen.*

**Mbi mekanizmat për parandalimin e konfliktit të interesit:**

*Rregullorja/procedura e miratuar* që rregullon identifikimin, deklarimin, trajtimin dhe parandalimin e konfliktit të interesit **specifikisht për procesin e raportimit financiar** (përgatitje, verifikim, miratim, konsolidim);

*Deklaratat e firmosura të konfliktit të interesit* nga i gjithë personeli i përfshirë në procesin e raportimit financiar për vitin 2024 (qendra dhe njësitë vartëse);

*Evidencë të trajnimeve apo udhëzimeve të zhvilluara mbi konfliktin e interesit* për personelin financiar dhe personat e ngarkuar në raportim financiar gjatë 2024.

**Mbi vlerësimin etik dhe kontrollin e brendshëm mbi personelin financiar;**

*Planifikimi dhe dokumentacioni i realizimit të vlerësimit etik* për personelin financiar për vitin 2023–2024 (metodologjia, kriteret, procesverbalet, raportet e vlerësimit);

*Dokumentacion mbi mekanizmat e kontrollit të brendshëm* të aplikuar ndaj personelit financiar gjatë procesit të raportimit financiar (teste kontrollesh, lista verifikimi, ndërhyrje korrigjuese);

*Raportet e NjAB* (nëse ka) që adresojnë integritetin, etikën dhe kontrollin e brendshëm të lidhur me raportimin financiar për periudhën 2023–2024;

*Dokumente që provojnë zbatimin e Kodit të Etikës* (deklarime të nënshkruara, trajnime, masa disiplinore në rast shkeljesh, nëse ka).

**Mbi ndarjen e funksioneve në raportimin financiar;**

*Aktin zyrtar të miratuar (rregullore/urdhër/manual pune)* që përcakton ndarjen e roleve në procesin e raportimit financiar (përgatitje - verifikim - miratim - publikim/komunikim);

Matrica Ndarja e Funksioneve/Rolesh (Responsible – Accountable – Consulted – Informed) për procesin e raportimit financiar për vitin 2024;

Evidencat e zbatimit të ndarjes së funksioneve për një kampion prej minimumi 20 transaksionesh/procedurash raportimi financiar (log-e të sistemit, nënshkrime maker–checker–approver, lista aprovuese);

Nëse ka raste të justifikuar ku ndarja e funksioneve nuk është zbatuar sipas praktikës standarde (*p.sh. në procedurat e arkave në njësitë administrative*), kërkojmë dokumentacionin përkatës të aprovimit dhe mënyrën se si është siguruar kontrolli alternativ në ato rast

### **Mbi integritetin dhe transparencën e raportimit financiar:**

Aktet e brendshme të miratuara (rregullore/procedura/urdhra/manual pune) që rregullojnë procesin e raportimit financiar (përgatitje - verifikim - miratim - konsolidim - publikim/komunikim);

Pasqyrat financiare vjetore të vitit 2024 të firmosura dhe të miratuara sipas zinxhirit të kontrollit (maker–checker–approver), psh SIQF regjistruesi, NZ kontrolluesi dhe NA aprovues mënyrat e emërimit, rolet detyrat dhe përgjegjesite e secilit, së bashku me dokumentacionin justifikues mbi procesin;

Nëse ka situata të dokumentuara ku transparenca nuk është zbatuar sipas afateve ose procedurave standarde, kërkojmë evidencën shoqëruese dhe arsyetimin administrativ përkatës, si dhe masat e marra për korrigjim (nëse ka).

**Nga auditimi i të dhënave të vëna në dispozicion të grupit të auditimit për sa më sipër u konstatua se:**

Mbi mekanizmat për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare;

Në Bashkinë Korçë nuk ekzistojnë mekanizma të dokumentuar për parandalimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesit gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare. Nuk është miratuar procedurë për deklarimin e konfliktit të interesit për personelin financiar; nuk administrohen deklarata të nënshkruara përpara përfshirjes në proces; dhe nuk dokumentohet asnjë mekanizëm kontrolli etik mbi këtë funksion, në kundërshtim me: nenet 1, 2, 6 dhe 7 të Ligji nr. 9367/2005; neni 20 dhe neni 5 Ligji nr. 10296/2010.

Mungesa e dokumentimit dhe e mekanizmave parandaluese krijon risk që raportimi financiar të ndikohet nga interesa personale, duke cënuar paanshmërinë, integritetin dhe besueshmërinë e informacionit financiar të raportuar.

Kryetari i Bashkisë Korçë, Drejtoria e Financës dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm duhet të merrnin masa të miratonin dhe zbatonin procedurë të posaçme për deklarimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesit për personelin e përfshirë në raportimin financiar, të administrojnë deklarata të nënshkruara përpara përfshirjes në proces, dhe të dokumentojnë mekanizma kontrolli etik për të garantuar paanshmërinë dhe integritetin e informacionit financiar.

Mbi procesin e vlerësimit etik dhe kontrollit të brendshëm mbi personelin financiar;

Në Bashkinë Korçë nuk zhvillohet asnjë proces i formalizuar i vlerësimit etik ose kontrollit të brendshëm mbi personelin financiar në funksion të raportimit financiar, integritetit profesional dhe konfliktit të interesit, në kundërshtim me: nenin 6 të Ligji nr. 9367/2005; nenet 5 dhe neni 14 të Ligjit nr. 10296/2010.

Mungesa e vlerësimit etik dhe kontrollit të brendshëm rrit probabilitetin që vendimarrja financiare dhe raportimi i informacionit financiar të mos jenë të paanshme, të verifikueshme dhe në përputhje me kuadrin ligjor më fuqi.

Kryetari i Bashkisë Korçë, Drejtoria e Financës, Drejtoria e Burime Njerëzore dhe NJAB duhet të kryenin një proces të formalizuar të vlerësimit etik periodik për personelin financiar, të kryejnë

kontrolle të pavarura mbi integritetin dhe etikën profesionale, dhe të dokumentojnë rezultatet me qëllim rritjen e besueshmërisë së raportimit financiar në nivel të njërive vartëse dhe të konsoliduara.

*Mbi menaxhimin e rasteve kur një individ ushtron funksione të dyfishta në raportimin financiar:*

Në Bashkinë Korçë dokumentohet ndarja e funksioneve ndërmjet fazave të përgatitjes, verifikimit dhe miratimit të pasqyrave financiare. Nga auditimi nuk u konstatuan raste ku i njëjti individ ushtron funksione të dyfishta, duke përgatitur dhe njëkohësisht kontrolluar të njëjtat të dhëna financiare, *përvec rasteve të arkave në njësitë administrative.*

### **Hartimi, afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:**

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Bashkisë Korçë për vitin 2024 (të cilat përfshijnë pasqyrat financiare ushtrimore të vitit 2024 të Aparati Bashkia Korçë, Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla”, Qendra Rezidenciale e Zhvillimit, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Klubi Shumësportësh Skënderbeu, Qendra Ditore e Zhvillimit dhe Qendra e Artit dhe Kulturës) janë të nënshkruara nga z. S. F. Kryetar i Bashkisë Korçë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe znj. V. Z. Drejtor i Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe hartuesit të pasqyrave financiare të konsoliduara ku janë depozituar në Degën e Thesarit Korçë, ku kanë marrë konfirmimin më datë 30.04.2025, brenda afatit ligjor. Pjesë e pasqyrave financiare të konsoliduara janë edhe Njësitë Shpenzuese të sipërcituara, të cilat kanë konfirmuar pasqyrat financiare individuale sipas korrespondencës të mëposhtme:

- Me shkresën nr. 2968 prot., datë 26.03.2025, Bashkia Korçë ka depozituar pasqyrat financiare në DTH Korçë, të cilat kanë marrë konfirmimin me praktikën nr. 400 prot., datë 26.03.2025;

- Me shkresën nr. 104 prot., datë 28.04.2025, Shtëpia e Foshnjës “Lulet e vogla” ka depozituar pasqyrat financiare në DTH Korçë, të cilat kanë marrë konfirmimin me praktikën nr. 104 prot., datë 30.04.2025, jashtë afatit ligjor. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”* i ndryshuar, Kapitulli V, pika 118.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. K. Gj.** Drejtor i SHFLV në cilësinë e titullarit të institucionit dhe nëpunësit autorizues dhe **z. P. Sh.** me detyrë Përgjegjës i Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe hartuesit të pasqyrave financiare.

- Me shkresën nr. 36 prot., datë 21.03.2025, Qendra Rezidenciale e Zhvillimit ka depozituar pasqyrat financiare në DTH Korçë, të cilat kanë marrë konfirmimin me praktikën nr. 416 prot., datë 28.03.2025;

- Me shkresën nr. 293 prot., datë 11.03.2025, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike ka depozituar pasqyrat financiare në DTH Korçë, të cilat kanë marrë konfirmimin me praktikën nr. 395 prot., datë 26.03.2025;

- Me shkresën e datës 27.03.2025, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse Arsimit dhe Çerdhes ka depozituar pasqyrat financiare në DTH Korçë, të cilat kanë marrë konfirmimin me praktikën nr. 406 prot., datë 27.03.2025;

- Me shkresën nr. 398 prot., datë 26.03.2025, Klubi Shumësportësh “Skënderbeu” ka depozituar pasqyrat financiare në DTH Korçë, të cilat kanë marrë konfirmimin me praktikën nr. 398 prot., datë 26.03.2025;

- Me shkresën nr. 77 prot., datë 21.03.2025, Qendra Ditore e Zhvillimit ka depozituar pasqyrat financiare në DTH Korçë, të cilat kanë marrë konfirmimin me praktikën nr. 392 prot., datë 25.03.2025;

- Me shkresën nr. 70 prot., datë 17.03.2025, Qendra e Artit dhe Kulturës ka depozituar pasqyrat financiare në DTH Korçë, të cilat kanë marrë konfirmimin me praktikën e datës 27.03.2025;

### **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:**

Për vitin 2024 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e Klasës 6 dhe Klasës 2 me akt-rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

### **Sa i përket procesit të raportimit financiar dhe përputhshmërisë së tij, u konstatua se:**

Për vitin 2024 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar janë përgatitur pasqyrat financiare të konsoliduara të përbëra si më poshtë:

- **Formati 1** – Pasqyra e pozicionit financiar;
- **Formati 2** – Pasqyra e performancës financiare;
- **Formati 3** – Pasqyra e flukseve monetare;
- **Formati 4** – Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- **Formati 5** – Pyetësori me shënimet shpjeguese.

#### **Pasqyrat statistikore:**

- **Formati 6** – Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre;
- **Formati 7/a dhe 7/b** – Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (a) dhe me vlerën neto (b);
- **Formati 8** – Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondit të pagave.

Në lidhje me këto formate u konstatua se:

Formatet financiare dhe statistike të sipërcituara janë përgatitur në përputhje me kërkesat formale të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar, por cilësia dhe plotësia e të dhënave të pasqyruara në to varet nga proceset paraprake të regjistrimit, verifikimit dhe miratimit të informacionit financiar.

Në formatet e përgatitura, **të cilat përmbledhin në mënyrë shumatore të dhënat e raportuara nga njësitë vartëse**, mungojnë shënimet shpjeguese dhe provat mbështetëse mbi proceset e kontrollit dhe verifikimit të dokumentacionit që ka shërbyer si bazë për regjistrimin e të dhënave në pasqyrat e konsoliduara, si dhe nuk dokumentohen arsyet e lëvizjeve ndërvite të zërave buxhetorë, siç kërkohet nga struktura raportuese.

Për disa prej zërave të raportuar, nuk evidentohet dokumentacion provues në dosjen e raportimit financiar, çka kufizon gjurmueshmërinë dhe verifikueshmërinë e saktësisë së të dhënave të pasqyruara, konkretisht

Nga auditimi i *pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara në njësinë e qeverisjes së përgjithshme* subjekt në auditim rezulton se në raportimin financiar për vitin ushtrimor të mbyllur më 31.12.2024 struktura standarte e formularëve “Formati nr.1” deri te “Formati 8” janë hartuar duke respektuar ndarjen funksionale konkretisht:

Pasqyra e pozicionit financiar; Struktura standarte e formularit “Formati nr.1” është hartuar duke respektuar ndarjen funksionale në Aktive, Pasive dhe Aktive Neto/Fonde, me referencim të qartë të llogarive buxhetore përbërëse sipas planit të llogarive me informacion mbi periudhën ushtrimore dhe atë paraardhëse, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi. Respektivisht të dhënat sipas ndarjes funksionale paraqiten në tabelën më poshtë:

Pasqyra e pozicionit financiar të dhënat sipas ndarjes funksionale në lekë;

Nr.	Struktura funksionale	EMERTIMI	Ushtrimi i mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
1	A	AKTIVET	12,590,219,628	12,932,061,388
2		I. Aktivët Afat shkurtra	1,362,921,468	1,356,849,595
3		II. Aktivët Afat gjata	11,227,298,160	11,575,211,793
4	B	PASIVET(DETYRIMET)	1,004,692,311	1,024,526,331
5		I. Pasivët Afat shkurtra	1,004,692,311	997,985,628
6		II. Pasivët Afat Gjata	0	26,540,703
7	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	11,585,527,316	11,907,535,057
8	D	FONDI I KONSOLIDUAR	11,585,527,316	11,907,535,057
9	E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	12,590,219,628	12,932,061,388

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë.

*Pasqyra e performancës financiare;* Struktura standarte e formularit “Formati nr. 2” është hartuar duke respektuar ndarjen funksionale në: **A. Të Ardhurat**, sipas nënkategorive, konkretisht: *Të ardhurat nga Taksat dhe Tatimet, Kontribute Sigurime Shoqerore e Shëndetësore, Të Ardhura Jo Tatimore, Të Ardhura Financiare, Grante Korente, Të Ardhura të tjera, Ndryshimi i gjendjes së inventarit ekonomik.* **B. Shpenzimet** sipas nënkategorive, konkretisht: *Pagat dhe Perfitimet e Punonjësve, Kontribute të Sigurimeve, Blerje Mallra e Shërbime, Subveçione, Transferime Korente, Shpenzime Financiare, Kuota Amortizimi dhe Shuma të Parashikuara, Ndryshimi i Gjendjes së Inventarit, Shpenzime të tjera, Teprica ose Deficiti i Periudhës (Rezultati i Veprimtarisë së Vitit Ushtrimor).*

Struktura e hartuar është plotësuar me referencim të qartë të llogarive buxhetore përbërëse sipas planit të llogarive me informacion mbi periudhën ushtrimore dhe atë paraardhëse, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi. Respektivisht të dhënat sipas ndarjes funksionale paraqiten në tabelën më poshtë:

Pasqyra e performancës financiare të dhënat sipas ndarjes funksionale në lekë:

Nr	Reference llogarive	Përshkrimi i operacioneve	Viti ushtrimor	Viti i mëparshëm
1	A	TE ARDHURAT	3,862,723,270	3,603,283,060
2	70	I.Te ardhurat nga taksat e tatimet	397,793,521	384,316,883
3	75	II.Kontribute sig.e shoq.e shend.	0	0
4	71	III.Te ardhura jo tatimore	278,385,537	262,766,550
5	76	IV.Te ardhura financiare	0	0
6	72	V.Grante korente	3,076,683,118	2,796,624,287
7		VI.Te ardhura te tjera	109,861,095	159,575,339
8	73	VII.Ndryshimi i gjendjes se inv. te prod.	0	0
9	B	SHPENZIMET	3,694,310,055	3,452,118,286
10	600	I.Pagat dhe perfitimet e punonjseve	839,497,467	759,234,673
11	601	II.Kontribute te sigurimeve	139,941,540	125,632,951
12	602	III.Blerje mallra e sherbime	726,423,992	611,732,381
13	603	IV.Subveçione	10,200,795	10,626,143
14		V.Transferime korente	1,870,494,162	1,796,345,085
15		VI.Shpenzime financiare	868,449	2,827,855
16		VII.Kuota amort. dhe shuma te parash.	0	0
17	63	VIII.Ndryshimi i gjendjes se inventarit	18,237,892	4,320,673
18		IX.Shpenzime te tjera	88,645,758	141,398,525
19	85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES	168,413,216	143,149,845
20		(Rezultati I Veprimtarise se vititUshtrimor)	0	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë.

*Pasqyra e flukseve monetare;* Struktura standarte e formularit “Formati nr. 3” është hartuar duke respektuar ndarjen funksionale në, Veprimtaritë e Shfrytëzimit, Veprimtaritë e Investimeve, Transferta e të tjera, Rritja /Rënia neto e Mjeteve monetare, Teprica në fillim të vitit ushtrimor, Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor.

Struktura e hartuar është plotësuar me referencim të qartë të llogarive buxhetore përbërëse sipas planit të llogarive me informacion mbi periudhën ushtrimore dhe atë paraardhëse, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi. Respektivisht të dhënat sipas ndarjes funksionale paraqiten në tabelën më poshtë:

Pasqyra e flukseve monetare, të dhënat sipas ndarjes funksionale në lekë.

Nr.	Nr rubrike	PERMBAJTJA	Periudha raportuese	Periudha Paraardhese
1	I	Veprimtarite e shfrytezimit	101,114,339	-322,751,246
2	II	Veprimtarite e investimeve	-131,314,381	-104,082,117
3	III	Transferta e te tjera	-655,236,047	-635,196,481
4	IV	Rritja /Renia neto e Mjeteve monetare	-685,436,088	-1,041,624,374
5	V	Teprica ne fillim te vitit ushtrimor	314,016,580	351,937,387
6	VI	Teprica e Likuiditeve ne fund te vitit ushtrimor	227,006,697	314,016,580

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë.

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto; Struktura standarte e formularit “Formati nr. 4” është hartuar duke respektuar ndarjen funksionale në, Aktivet Neto/Fondet Neto, Ndryshimet në Aktivet/ Fondet Neto, Totali i Fondeve të veta.

Struktura e hartuar është plotësuar me referencim të qartë të llogarive buxhetore përbërëse sipas planit të llogarive si dhe me informacion mbi aktivitetin financiar për periudhën ushtrimore, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi. Respektivisht të dhënat sipas ndarjes funksionale paraqiten në tabelën më poshtë:

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto, të dhënat sipas ndarjes funksionale në lekë.

Nr	Reference	EMERTIMI	Fonde dhe baze Kapitale	Rezerva	Fonde te tjera te veta	Rezultatet e Mbartura Teprioc e/Deficit	Rezultatet e Ushtrimit Teprioc/De ficit	GJITHESEJ Aktive/neto Fonde/ Neto
1	101	I.AKTIVET NETO/FONDET NETO	11,907,535,057	0	0	0	178,390,992	12,085,926,049
2		II.NDRYSHIMET NE AKTIVET/ FONDET NETO (1+2)	0	0	0	0	-500,398,732	-500,398,732
3		1.NGA BURIME TE BRENDSHME	0	0	0	0	-500,518,712	-500,518,712
4		2.NGA BURIME TE JASHTME	0	0	0	0	119,980	119,980
5		TOTALI I FONDEVE TE VETA(I+II)	11,907,535,057	0	0	0	-11,080,701	11,585,527,316

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë.

Pyetësori me shënimet shpjeguese; Struktura standarte e formularit “Formati nr.5” është hartuar duke respektuar ndarjen funksionale dhe është pjesë integrale e pasqyrave për vitin ushtrimor.

Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre; Struktura standarte e formularit “Formati nr. 6” është hartuar duke respektuar ndarjen funksionale në Shpenzimet për investime; Burimet për investime.

Struktura e hartuar është plotësuar me referencim të qartë të llogarive buxhetore përbërëse sipas planit të llogarive si dhe me informacion mbi aktivitetin financiar për periudhën ushtrimore, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.

Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre, të dhënat sipas ndarjes funksionale në lekë;

Nr.	Referenca e Llogarive	EMERTIMI	Teprica ne Fillim te Vitit	Transaksionet e vitit		Teprica ne fund
				Debi	Kredi	
1	I.	SHPENZIMET PER INVESTIME	170,137,677	143,627,091	145,762,889	168,001,879
2	II.	BURIMET PER INVESTIME	134,987,773	3,064,686,770	3,073,591,032	143,892,035
3	105	1.Grante te brendshme kapitale	77,592,922	2,980,466,163	3,030,567,679	127,694,438
4	106	2.Grante te huaja Kapitale	0	4,075,725	4,075,725	0
5	14	3.Grante kapitale per investime per te trete	0	0	0	0
6	11	4.Fonde te tjera te veta.	30,854,148	53,604,179	38,947,628	16,197,597
7	12	5.Rezultati I Mbartur	2,125,816	2,125,816	0	0
8	16,17	6.Huamarrje	26,540,703	26,540,703	0	0
9	III.	BALANCA (II-I)	-35,149,903	2,921,059,679	2,927,828,143	-24,109,844

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë.

Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (a) dhe me vlerën neto (b); Struktura standarte e formularit “Formati nr. 7 (a) dhe (b)” është hartuar duke respektuar ndarjen funksionale dhe është plotësuar me referencim të qartë të llogarive buxhetore përbërëse sipas planit të llogarive si dhe me informacion mbi aktivitetin financiar për periudhën ushtrimore, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.

Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike Formatit nr.7/a, të dhënat sipas ndarjes funksionale në lekë.

Nr.	Reference Llogarie	E M E R T I M I	Gjendje ne fillim te vitit	Shtesa gjate vitit ushtrimo, Kosto Historike	Pakesime gjate vitit, Kosto Historike	Gjendja mbyllje te ushtrimit
				Gjithesej	Gjithesej	
1	20	I. AAGJ/JO MATERIALE	35,554,161	3,086,806	506,920	38,134,047
2	21- 28	II. TAAGJ/ MATERIALE	14,521,503,169	1,703,924,489	1,579,600,944	14,645,826,714
3		T O T A L I (I + II)	14,557,057,330	1,707,011,295	1,580,107,864	14,683,960,761

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë.

Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto (b) të dhënat sipas ndarjes funksionale në lekë.

Nr.	Reference Llogarie	E M E R T I M I	Gjendje ne fillim te vitit	Shtesa gjate vitit ushtrimo, Kosto Historike	Pakesime gjate vitit, Kosto Historike	Gjendja mbyllje te ushtrimit
				Gjithesej	Gjithesej	
1	20	I. AAGJ/JO MATERIALE	35,554,161	3,086,806	506,920	38,134,047
2	21- 28	II. TAAGJ/ MATERIALE	14,521,503,169	1,703,924,489	1,579,600,944	14,645,826,714
3		T O T A L I (I + II)	14,557,057,330	1,707,011,295	1,580,107,864	14,683,960,761

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë.

Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondit të pagave; Struktura standarte e formularit “Formati nr. 8” është hartuar duke respektuar ndarjen funksionale në: Personel drejtues, Specialist me arsim të lartë, teknik, nëpunës të thjeshtë, punëtorë dhe punpunjës të përkohshëm.

Struktura është plotësuar me informacion të qartë mbi ndryshimet gjatë vitit (punonjës të rinj, të larguar si dhe fondin respektiv për paga dhe contribute mbi sigurimet Shoqërore dhe shëndetësore në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.

**Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:**

Për t’u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t’u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

### **Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti përgjithësisht është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhen me veprim ekstra-kontabël.
- Përgjithësisht janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Në përgjithësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësi, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë përgjithësisht elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

### **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare të konsoliduara, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Korçë për aktivitetin ekonomiko-financiar **për periudhën 01.01.2024, deri më datën 31.12.2024**. Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2024 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2023. Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2024 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike.

### **Mbi llogaritjen e nivelit të materialitetit për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2024:**

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të disponueshme dhe të siguruara nga vetë subjekti. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin

2023 ka marrë në konsideratë vlerën e precizionit 69,529 mijë lekë për të ardhurat ku materialiteti paraqitet **77,254 mijë lekë** dhe • ardhurat dhe vlerën e precizionit **59,847 mijë lekë** për shpenzimet ku materialiteti paraqitet **73,886 mijë lekë**, sipas pasqyrave më poshtë:

### **Pasqyra e Llogaritjes së nivelit të materialitetit për të ardhurat për vitin 2024, në lekë:**

Emërtimi i të ardhurave	Vlera e popullatës	Faktori i Riskut (mund të jetë 0.7 ose 2 ose 3)	Çështje për tu shqyrtuar
<b>Totali i te ardhurave</b>	<b>3,862,723,270</b>	<b>0.70</b>	<b>43</b>
TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	<b>397,793,521</b>	<b>0.70</b>	<b>4</b>
Tatim mbi Pasurine e paluajtshme (7020)	157,764,819	0.70	2
Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie (7035)	229,373,075	0.70	3
<b>TE ARDHURA JO TATIMORE</b>	<b>278,385,537</b>	<b>0.70</b>	<b>3</b>
Te ardhura sekondare e pagesa shërbimesh (7110)	197,843,972	0.70	2
<b>GRANTE KORENTE</b>	<b>3,076,683,118</b>	<b>0.70</b>	<b>34</b>
Nga Buxheti per NJQP (Vendore) (7201)	2,194,572,576	0.70	25
Pjesmarje e institucioneve ne tatime nacionale (7204)	86,892,669	0.70	1
Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit (7205)	455,133,814	0.70	5
Terheqje nga seksioni i investimeve (787)	109,861,095	0.70	1
Te tjera poshte materialitetit te përcaktuar (7109, 7111,7113,7115,7200,7211)	151,819,112	0.70	2
<b>Total</b>	<b>3,862,723,270</b>	<b>0.70</b>	<b>43</b>
Materialiteti në %	2%		
<b>Materialiteti</b>	<b>77,254,465</b>		
Kalkulimi i precizionit			
<b>Materialiteti</b>	<b>77,254,465</b>		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	7,725,447		
<b>Nëntotali</b>	<b>69,529,019</b>		
Precizioni i planifikuar (80 -90%)	90%		

### **Pasqyra e llogaritjes së nivelit të materialitetit për shpenzimet për vitin 2024, në lekë:**

Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (mund të jetë 0.7 ose 2 ose 3)	Çështje për tu shqyrtuar
<b>Totali Shpenzimeve</b>	<b>3,694,310,055</b>	<b>0.70</b>	<b>43</b>
Paga, personel (600)	839,497,467	0.70	10
Mallra e Shërbime speciale (6021)	178,575,496	0.70	2
Shërbime nga te trete (6022)	281,385,611	0.70	3
Shpenzime te tjera operative (6029)	82,808,499	0.70	1
Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme(6041)	1,093,305,267	0.70	13
Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse(6044)	130,480,345	0.70	2
Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor(6061)	613,839,657	0.70	7
Investime të brend. (230-231)	168,001,879	0.70	2
Te tjera shpenzime nen materialitet (6020,6023,6024,6025,6026,6030)	191,325,444	0.70	2
<b>Total</b>	<b>3,694,310,055</b>		
Materialiteti në %	2%		
<b>Materialiteti në vlerë</b>	<b>73,886,201</b>		
Kalkulimi i precizionit			
<b>Materialiteti</b>	<b>73,886,201</b>		
Gabimi i lejuar (10% - 20%)	7,388,620		
<b>Nëntotali</b>	<b>66,497,581</b>		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%		
<b>Vlera e precizionit</b>	<b>59,847,823</b>		

### **Mbi vlerësimin e riskut:**

Nga grupi i auditimit janë ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Më poshtë po citojmë disa ngjarje që mund të paraqesin një risk të gabimit material:

- Kontrolli i brendshëm:

Kontrolli i brendshëm në Bashkinë Korçë nuk ka funksionuar i plotë, nuk përfshin gjithë veprimtarinë e njësisë ekonomike, si rrjedhim nuk ndihmon në verifikimin e realizimit të detyrave dhe njësia ekonomike nuk mund ta dijë ku mund të ndodhin parregullsitë, shmangiet nga normat dhe kriteret e veprimtarisë ekonomike. Zbatimi i rregullt i procedurave të kontrollit të brendshëm shërben për ti siguruar menaxherët se pasuria e njësisë është e mbrojtur, të dhënat e përpunuara në kontabilitet janë të besueshme.

- Konfirmimet nga të tretët:

Subjekti që auditohet ka të konfirmuara (rakorduara) me të tretët (me degën e thesarit) informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

- Transaksionet:

*Janë kryer transaksione me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë në periudhën e fundit të vitit ushtrimor.*

Nisur nga ky fakt, bazuar në vlerën e materialitetit të përlloritur **77,254 mijë lekë** për të ardhurat **73,886 mijë lekë** për shpenzimet u evidentuan të gjitha kontabilizimet sipas llogarive që ishin materiale në vlerë për të ardhurat dhe Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës që ishin materiale në vlerë për muajin dhjetor 2024.

Urdhër Shpenzimet e filtruara u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik” për regjistrimin e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; Dokumentet autorizues, Dokumentet vërtetues, Dokumentet e kontabilitetit, etj.

**Teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:**

1. Kontrolli aritmetik:

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

4. Kontrolli i vlerësimit:

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmimi nga të tretët:

Subjekti që auditohet i ka të konfirmuara (rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

### 6. Kontrolli sipas një treguesi:

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabile. Mund të përmendim nëse ka: *mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshhta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, etj.*

### **2.3.1 Auditimi mbi Plotësinë dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.**

#### **Procesi i inventarizimit:**

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, neni 74, parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës. Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve, shtesat, pakësimet apo nxjerrjen jashtë përdorimit të evidentuara në Pasqyrën nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)”, Pasqyrën nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)”, kartelat sipas personave të cilën kanë aktive në përdorim, urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimin, asgjesimit, relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarizimit, procedurat për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit, fletë-hyrjeve dhe fletë-dajet nga magazina etj.,.

#### **➤ Aparati i Bashkisë Korçë:**

Me Urdhrin nr. 1120, datë 01.11.2024, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve të institucionit për vitin 2024, i përbërë nga 11 punonjës. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i sipërcituar është hartuar relacioni përmbledhës, ku propozohen për nxjerrje jashtë përdorimit aktivet në vlerën totale 1,862,143.62 lekë që i përket llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në vlerën 341,580 lekë; 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 1,267,267 lekë dhe 327 “Inventar i imët” në vlerën 253,296 lekë sipas të dhënave në mënyrë të përmbledhura të mëposhtme:

Lekë					
Nr.	Emërtimi i inventarit	Vlera	214	218	327
1	Bashkia Korçë	1,033,507	334,680	698,827	55,637
2	Njësia Administrative Bulgarec	195,800	-	195,800	-
3	Njësia Administrative Drenovë	35,520	-	35,520	22,893
4	Njësia Administrative Mollaj	225,000	-	225,000	90
5	Njësia Administrative Voskop	54,120	-	54,120	3,147
6	Njësia Administrative Voskopoje	-	-	-	-
7	Njësia Administrative Vithkuq	-	-	-	1,500
8	Njësia Administrative Lekas	4,000	-	-	2,600
9	MZSh	60,900	6,900	54,000-	167,430
<b>Totali</b>		<b>1,608,847</b>	<b>341,580</b>	<b>1,267,267</b>	<b>253,296</b>

Me Urdhrin nr. 1323, datë 19.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur komisioni për vlerësimin e aktiveve të propozuara nga komisioni i inventarizimit për nxjerrje jashtë përdorimit. Nga komisioni i sipërcituar është hartuar Raporti i Vlerësimit, i cili ka realizuar procesin e verifikimit fizik të aktiveve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit, ku ka konstatuar se gjendja e tyre është e dëmtuar dhe e pa riparueshme dhe të pa përshtatshme për përdorim të mëtejshëm, sipas të dhënave të mëposhtme:

Lekë

Llog	Aktive për asgjesim	Amortizimi	Vlerë e mbetur	Aktive për riciklim (skrap)	Amortizimi	Vlerë e mbetur	Aktive për riciklim (paj.komp.& elektrike)	Amortizim	Vlerë e mbetur	Total jashtë përdorimi
214							341,580	274,083	67,497	341,580
218	222,540	186,165	36,375	132,200	96,648	35,552	912,527	782,071	130,456	1,267,267
327	234,322			15,068			3,907			253,297
<b>Total</b>	<b>456,862</b>	<b>186,165</b>	<b>36,375</b>	<b>147,268</b>	<b>96,648</b>	<b>35,552</b>	<b>1,258,014</b>	<b>1,056,154</b>	<b>197,953</b>	<b>1,862,144</b>

Vlen të theksohet se pjesë e Raportit të Vlerësimit, është edhe vlerësimi i automjeteve të institucionit, të cilat janë konstatuar jo në gjendje pune, të amortizuara mesatarisht në masës 86%, të detajuara sipas tabelës si më poshtë:

Lekë

Nr.	Emërtimi i aktivitetit	Targa	Nr.shasie	Vleftha	Amortizimi akumuluar	% amortizimit	Vlera e mbetur
1	Land Rover Defender	KO8491B	SALLDHM584A671235	1,611,081	1,483,655	92%	127,426
2	Mitsubishi Pajero Sport	AA904GR	JMB0NK9403J004316	1,652,415	1,493,003	90%	159,412
3	Audi A6	AA266TL	ËAUZZZ4FX5N109895	1,541,460	1,126,433	73%	415,027
4	Volksaëagen Transporter	AA340RG	ËV2ZZZ70Z3X073020	995,889	858,666	86%	137,223
5	Motorçikletë	KO713A	LD6XCB02874000001	49,800	48,981	98%	819
<b>Totali</b>				<b>5,850,644</b>	<b>5,010,737</b>	<b>86%</b>	<b>839,907</b>

Në zbatim të Urdhrit nr. 1360, datë 31.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë me objekt “Për dhënie në përdorim/tjetërsimin e aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve”, komisioni pas numërimit dhe verifikimit fizik të të gjithë aktiveve që janë në gjendje të dëmtuar dhe amortizuar përtej limiteve të përcaktuara, ka vendosur të nxjerrë jashtë përdorimit aktivet sipas vlerave të mëposhtme:

- ✓ Aktive Afatgjata në vlerën 1,608,847 lekë;
- ✓ Aktive Afatshkurtra materiale në vlerën 253,296.62 lekë;

- Për sa i përket aktiveve afatgjatë materiale për asgjesim në vlerën 222,540 lekë dhe aktiveve afatshkurtër (inventar i imët) për asgjesim në vlerën 234,321.58 lekë, komisioni ka vendosur t'i nxjerri jashtë përdorimit duke i asgjesuar me groposje.

- Aktivet afatgjatë materiale për riciklim (skrap) në vlerën 132,200 lekë dhe aktivet afatshkurtër (inventar i imët) për riciklim (skrap) në vlerën 15,068 lekë, komisioni ka vendosur t'i nxjerrë jashtë përdorimit dhe t'ia kalojë Drejtorisë së Përgjithshme të Plamifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës për vlerësim dhe kalim për skrap.

- Aktivet afatgjatë materiale për riciklim (pajisje elektrike & elektronike) në vlerën 1,254,107 lekë dhe aktivet afatshkurtër (inventar i imët) për riciklim (pajisje elektrike & elektronike) në vlerën 3,907 lekë, komisioni ka vendosur t'i nxjerrë jashtë përdorimit dhe së bashku me aktivet afatgjatë materiale automejete, në vlerën 5,850,644 lekë, dhe t'ia kalojë Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, për veprime të mëtejshme.

#### ➤ Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla”:

Me Urdhrit nr. 33, datë 21.11.2024, të Drejtorit të ShFLV është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve të institucionit për vitin 2024, i përbërë nga 5 punonjës. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i sipërcituar është hartuar relacioni përmbledhës, ku propozohen për nxjerrje jashtë përdorimit aktivet në vlerën totale 1,055,907.40 lekë që i përket llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në vlerën 21,000 lekë; 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 740,499 lekë dhe 327 “Inventar i imët” në vlerën 294,408.40 lekë sipas të dhënave në mënyrë të përmbledhura të mëposhtme:

Lekë

Nr.	Emërtimi i inventarit	Vlera	214 Instalime teknike, makineri e pajisje	218 Inventar ekonomik	327 Inventar i imët
1	Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla”	1,055,907.40	21,000	740,499	294,408.4
<b>Totali</b>		<b>1,055,907.40</b>	<b>21,000</b>	<b>740,499</b>	<b>294,408.4</b>

Me Urdhrin nr. 33, datë 21.11.2024, të Drejtorit të ShFLV është ngritur komisioni për vlerësimin e aktiveve të propozuara nga komisioni i inventarizimit për nxjerrje jashtë përdorimit. Nga komisioni i sipërcituar është hartuar Raporti i Vlerësimit, i cili ka realizuar procesin e verifikimit fizik të aktiveve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit, ku ka konstatuar se gjendja e tyre është e dëmtuar dhe e pa riparueshme dhe të pa përshtatshme për përdorim të mëtejshëm, sipas të dhënave të mëposhtme:

Aktive	Aktive për asgjesim	Amortizimi	Vlerë e mbetur	Total jashtë përdorimi	Lekë
214	21,000	14,500	6,500	21,000	
218	740,499	370,618	369,381	740,499	
327	294,408	-	294,408	294,408	
<b>Totali</b>	<b>1,055,907</b>	<b>385,118</b>	<b>670,289</b>	<b>1,055,907</b>	

Në zbatim të Urdhrit nr. 33, datë 21.12.2024, të Drejtorit të ShFLV me objekt “Për dhënien në përdorim/tjetërsimin e aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve”, komisioni pas numërimit dhe verifikimit fizik të të gjithë aktiveve që janë në gjendje të dëmtuar dhe amortizuar përtej limiteve të përcaktuara, të riparueshme dhe nuk mund të përshtaten për përdorim të mëtejshëm, ka vendosur të nxjerrë jashtë përdorimit aktivet sipas vlerave të mëposhtme:

- ✓ Aktive afatgjatë materiale në total 761,499 lekë;
- ✓ Aktive afatshkurtër materiale (inventar i imët) në total 294,408 lekë;

Për sa i përket aktiveve afatgjatë materiale për asgjesim në vlerën 761,499 lekë dhe aktiveve afatshkurtër (inventar i imët) për asgjesim në vlerën 294,408 lekë, komisioni ka vendosur t’i nxjerrë jashtë përdorimit duke i asgjesuar me grososje. Nga auditimi u konstatua se, për sa i përket vlerave të aktiveve të asgjesuara, nuk janë kryer veprimet ç’rregjistruese në Pasqyrën nr. 7/a “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pikat 89-90.

**Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. K. Gj. Drejtor i Shtëpisë së Foshnjës “Lulet e Vogla” në cilësinë e NA, z. P. Sh. Përgjegjës i Sektorit të Financës në cilësinë e NZ dhe hartuesit të pasqyrave financiare.**

➤ **Qendra Rezidenciale e Zhvillimit:**

Me Urdhrin nr. 118/1, datë 16.12.2024, të Drejtorit të QRZh-së është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve të institucionit për vitin 2024, i përbërë nga 6 punonjës. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i sipërcituar është hartuar relacioni përmbledhës, ku propozohen për nxjerrje jashtë përdorimit aktivet në vlerën totale 604,990 lekë që i përket llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” sipas të dhënave në mënyrë të përmbledhura të mëposhtme:

Me Urdhrin nr. 118/3, datë 16.12.2024, të Drejtorit të QRZh -së është ngritur komisioni për vlerësimin e aktiveve të propozuara nga komisioni i inventarizimit për nxjerrje jashtë përdorimit i përbërë nga pesë punonjës. Ky komision ka kryer vlerësimin dhe verifikimin e aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata të inventarizuara në fund të vitit 2024, duke hartuar raportin e vlerësimit. Komisioni ka konstatuar se automjeti Ëolsvagen Furgon me tragë AB0840 me vlerë 950,000 kosto historike nuk është në gjendje pune dhe është i amortizuar, sipas të dhënave të mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i aktivitetit	Targa	Vlefte	Amortizimi akumuluar	% amortizimit	Vlera e mbetur	Lekë
1	Wolsvagen Furgon	AB0840	950.000	950.000	100	0	
<b>Totali</b>		<b>0</b>	<b>950.000</b>	<b>950.000</b>	<b>100</b>	<b>0</b>	

Me Urdhrin nr. 118/2, datë 16.12.2024, të Drejtorit të QRZh-së me objekt “Për dhënien në përdorim/tjetërsimin e aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve”, komisioni ka vendosur se aktivet që janë në gjendje të dëmtuar dhe amortizuar përtej limiteve të

përcaktuara, të pariparueshme dhe nuk mund të përshtaten për përdorim të mëtejshëm dhe mbeten për t'u nxjerrë jashtë përdorimit në vitet në vazhdim.

➤ **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike:**

Me Urdhrin nr. 578, datë 25.11.2024, të Drejtorit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve të institucionit i përbërë nga 11 punonjës, për periudhën nga data 24.11.2023, deri më 25.11.2024. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i sipërcituar është hartuar Raporti Përmbledhës, ku ka propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit aktive në vlerën totale prej 13,336,850 lekë që i përkasin llogarive 215 “Mjete transporti” në vlerën 12,541,740 lekë dhe 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 795,110 lekë.

Me Urdhrin nr. 633, datë 31.12.2024, të Drejtorit të NShP-së është ngritur komisioni për vlerësimin e aktiveve të propozuara nga komisioni i inventarizimit për nxjerrje jashtë përdorimit i përbërë nga pesë punonjës. Nga komisioni i sipërcituar është hartuar Raporti i Vlerësimit, i cili ka realizuar procesin e verifikimit fizik të aktiveve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit, ku ka konstatuar se gjendja e tyre është e dëmtuar dhe e pa riparueshme dhe të pa përshtatshme për përdorim të mëtejshëm, sipas të dhënave të mëposhtme:

Lekë				
Llogaria	Aktive për riciklim	Amortizim	Vlerë e mbetur	Total jashtë përdorimi
218	795,110	649,211	145,899	795,110
<b>Totali</b>	<b>795,110</b>	<b>649,211</b>	<b>145,899</b>	<b>795,110</b>

Gjithashtu nga komisioni i vlerësimit ka konstatuar se një pjesë e automjeteve nuk janë në gjendje pune dhe të amortizuara mesatarisht në masës 87% konkretisht:

Lekë							
Nr	Emërtimi i aktivitetit	Targa	Nr.shasie	Vlehtë	Amortizimi akumuluar	%	Vlera e mbetur
1	Rimorkiator	KO7179A	174129	1,800,000	1,566,119	87%	233,881
2	Makinë Man Kokë tërheqëse + kazan vetëshkarkues	KO7824B	ËMAH05ZZZ3G162523	2,220,000	1,931,546	87%	288,454
3	Eskavator Benati 3.16	BENATI	015124	6,651,740	5,787,453	87%	864,287
4	Kamion man	KO9422A	ËMA5051954M081118	1,870,000	1,627,023	87%	242,977
<b>Totali</b>				<b>12,541,740</b>	<b>10,912,141</b>	<b>87%</b>	<b>1,629,599</b>

Në zbatim të Urdhrit nr. 23, datë 14.02.2025, të Drejtorit të NShP-së me objekt “Për dhënien në përdorim/tjetërsimin e aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të llogarive 215 “Mjete transporti” dhe 218 “Inventar ekonomik”, komisioni pas numërimit dhe verifikimit fizik të të gjithë aktiveve që janë në gjendje të dëmtuar dhe amortizuar përtej limiteve të përcaktuara, të pariparueshme dhe nuk mund të përshtaten për përdorim të mëtejshëm, ka vendosur të nxjerrë jashtë përdorimit aktivet sipas vlerave të mëposhtme:

- ✓ Inventar ekonomik në vlerën 795,110 lekë;
- ✓ Mjete transporti në vlerën 12,541,740 lekë;

Referuar relacionit të hartuar nga komisioni për nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve, vlera prej 795,1100 lekë që i përket llogarisë 218 “Inventar ekonomik” do të kalojë për riciklim dhe vlera prej 12,541,740 lekë që i përket llogarisë 215 “Mjete transporti” do të nxirret jashtë përdorimit pasi t'i kalojë znj. A. Ç. inxhinier Gjeodet në rolin e Vlerësueses së Pasurive të Paluajtshme për vlerësim dhe kalimin në skrap apo riciklim.

➤ **Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes:**

Me Urdhrin nr. 1, datë 09.01.2024, të Drejtorit të NShMAÇ-së është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve të institucionit, për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i sipërcituar është hartuar Raporti Përmbledhës, ku ka propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit aktive në vlerën totale prej 10,252,350 lekë që i përkasin llogarive 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në vlerën 586,255 lekë, 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 8,909,020 lekë dhe 327 “Inventar i imët” në vlerën 777,075 lekë.

Me Urdhrin nr. 107, datë 04.12.2024, të Drejtorit të NShMAÇ-së është ngritur komisioni për vlerësimin e aktiveve të propozuara nga komisioni i inventarizimit për nxjerrje jashtë përdorimit i

përbërë nga pesë punonjës. Nga komisioni i sipërcituar është hartuar Raporti i Vlerësimit, i cili ka realizuar procesin e verifikimit fizik të aktiveve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit, ku ka konstatuar se gjendja e tyre është e dëmtuar dhe e pa riparueshme dhe të pa përshtatshme për përdorim të mëtejshëm, sipas të dhënave të mëposhtme:

Lekë

Nr.	Institucioni	327	218	Amortizimi Akumuluar 2024	Vlera e mbetur	214	Amortizimi Akumuluar 2024	Vlera e mbetur	Total
1	Raqi Qirinxhi	40,675	3,004,988	2,524,190	480,798			0	521,473
2	Themistokli Gërmenji	10,190	129,445	108,734	20,711			0	30,901
3	Faik Konica	27,060	236,330	198,517	37,813			0	64,873
4	Tefia Tashko	30,956	20,546	17,258	3,288	96,000	75,033	20,967	55,211
5	Ymer Dishnica	187,800	3,130,258	2,629,416	500,842	425,027	332,201	92,826	781,468
6	Puntoria	13,166	0		0			0	13,166
7	Zyrat	15,800	106,600	89,544	17,056			0	32,856
8	Çerdhe	49,530	124,560	104,630	19,930			0	69,460
9	Konvikti	311,276			0			0	311,276
10	Magazina Rikupero	90,622	2,156,294	2,156,294		65,228	65,228		
	<b>Shuma</b>	<b>777,075</b>	<b>8,909,020</b>	<b>7,828,583</b>	<b>1,080,437</b>	<b>586,255</b>	<b>472,462</b>	<b>113,793</b>	<b>1,880,683</b>

Në zbatim të Urdhrit nr. 112, datë 10.12.2024, të Drejtorit të NShMAÇ-së me objekt “Për dhënie në përdorim/tjetërsimin e aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve”, komisioni pas numërimit dhe verifikimit fizik të të gjithë aktiveve që janë në gjendje të dëmtuar dhe amortizuar përtej limiteve të përcaktuara, ka vendosur të nxjerrë jashtë përdorimit aktivet sipas vlerave të mëposhtme:

- ✓ Aktive Afatgjata në vlerën 9,475,275 lekë;
- ✓ Aktive Afatshkurtra në vlerën 777,075 lekë;

Pas përfundimit të procesit të asgjësimit, nga Përgjegjësi i Sektorit të Financës znj. J. T. më datë 17.03.2025, është hartuar informacioni në lidhje me inventarizimin e aktiveve të institucionit dhe materialeve të nxjerrja jashtë përdorimit, ku bashkëlidhur këtij informacioni ndodhen edhe procesverbalet e asgjësimit të nënshkruara nga z. I. S, z. D. Gj. dhe z. R. X.

➤ **Klubi Shumësportësh Skënderbeu:**

Me Urdhrin nr. 69, datë 19.12.2024, të Drejtorit të Klubit Shumësportësh Skënderbeu është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve të institucionit, për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i sipërcituar me shkresën nr. 69/2 prot., datë 31.12.2024, është hartuar Raporti Përmbledhës.

➤ **Qendra Ditore e Zhvillimit:**

Me Urdhrin nr. 14, datë 20.12.2024, të Drejtorit të QDZh-së është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve të institucionit, për periudhën nga data 01.11.2023, deri më 31.10.2024. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i sipërcituar është hartuar Raporti Përmbledhës, ku ka propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit aktive në vlerën totale prej 155,600 lekë që i përkasin llogarive 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në vlerën 98,600 lekë dhe 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 57,000 lekë.

➤ **Qendra e Artit dhe Kulturës:**

Me Urdhrin nr. 161, datë 28.10.2024, të Drejtorit të QAK-së është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve të institucionit, për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i sipërcituar është hartuar Raporti Përmbledhës, ku ka propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit aktive në vlerën totale prej 5,583,515 lekë që i përkasin llogarive 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në vlerën 661,900 lekë, 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 1,167,408 lekë dhe 327 “Inventar i imët” në vlerën 3,754,207 lekë. Me Urdhrin nr. 178, datë 21.11.2024, të Drejtorit të QAK-së është ngritur komisioni për vlerësimin e aktiveve të propozuara nga komisioni i inventarizimit për nxjerrje jashtë përdorimit i përbërë nga pesë punonjës.

Nga komisioni i sipërcituar është hartuar Raporti i Vlerësimit, i cili ka realizuar procesin e verifikimit fizik të aktiveve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit, ku ka konstatuar se gjendja e tyre është e dëmtuar dhe e pa riparueshme dhe të pa përshtatshme për përdorim të mëtejshëm, sipas të dhënave të mëposhtme:

Lekë							
Llogaria	Aktive për asgjesim	Amortizimi	Vlerë e mbetur	Aktive për riciklim	Amortizim	Vlerë e mbetur	Total jashtë përdorimi
<b>Aktive afatgjatë</b>	<b>935,008</b>	<b>693,068</b>	<b>241,940</b>	<b>894,300</b>	<b>894,300</b>	<b>0</b>	<b>1,829,308</b>
214	34,900	34,900	0	627,000	627,000	0	661,900
218	900,108	658,168	241,940	267,300	267,300	0	1,167,408
<b>Aktive afatshkurtër 312-327</b>	<b>3,754,207</b>						<b>3,754,207</b>
<b>Totali</b>	<b>4,489,215</b>	<b>693,068</b>	<b>241,940</b>	<b>894,300</b>	<b>894,300</b>	<b>229,148</b>	<b>5,583,515</b>

Në zbatim të Urdhrit nr. 180, datë 02.12.2024, të Drejtorit të QAK-së me objekt “Për ngritjen e komisionit të asgjesimit për aktivet e dala jashtë përdorimit”, komisioni pas numërimit dhe verifikimit fizik të të gjithë aktiveve që janë në gjendje të dëmtuar dhe amortizuar përtej limiteve të përcaktuara, ka kryer asgjesimin fizik me djegie dhe propozje të aktiveve të mëposhtme:

- ✓ Aktive Afatgjata materiale në vlerën 935,008 lekë;
- ✓ Aktive Afatshkurtra në vlerën 3,754,207 lekë;
- ✓ Aktive për riciklim në vlerën 894,300 lekë;

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2024, të pozicionit financiar të Bashkisë Korçë formati nr. 1, paraqitet në pasqyrat financiare të mëposhtme. Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivitetit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2024, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si më poshtë:

Lekë	
Të dhënat sipas pasqyrave financiare të konsoliduara më datë 31.12.2024	
<b>Aktivet Neto janë të barabarta me Aktivet - Pasive = Aktivet Neto</b>	<b>11,585,527,316</b>
Aktivet	12,590,219,628
Pasivet	1,004,692,311
Aktivet Neto	11,585,527,316

Lekë	
<b>Aktivet Afatshkurtra më datë 31.12.2024</b>	<b>1,362,921,468</b>
Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre”	227,006,697
Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”	212,959,067
Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”	922,955,704

### **Mbi ndryshimin e gjendjes së “INVENTARIT”;**

Bazuar në nivelin e materialitetit të përcaktuar më sipër grupi i auditimit për t’u siguruar nëse:

- Regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi;
- Informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm; kreu verifikimin e përputhjes së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike duke filluar nga inventarët dhe *Pasqyra e performancës financiare etj.*, konkretisht: Për të vlerësuar procesin e inventarizimit në Bashkinë Korçë grupi i auditimit mori në shqyrtim gjithë llogaritë të cilat kanë dhënë efekt në rezultatin e vitit 2024 si rezultat i ndryshimit të gjendjes së inventarit të tyre, konkretisht:

Pasqyra me referencat e llogarive që kanë dhënë efekt në rezultatin e vitit 2024 si pasojë e ndryshimit të gjendjes së inventarit, të dhënat sipas ndarjes funksionale në lekë

Nr.	Referenca e Llogarive	Gjendje Inventari qarkullues	Viti 2024	Viti 2023
1	31	Materiale	86,455,325	84,027,765
2	32	Inventar I imet	116,349,677	137,679,760
3	33	Prodhim nre proces	0	0
4	34	Produkte	10,154,065	9,489,435
5	35	Mallra	0	0

6	36	Kafshe ne rritje e majmeri	0	0
7	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve	0	0
8	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit	0	0
9	39	Provigjone per zhvlersimin e inventarit (-)	0	0
<b>Total</b>			<b>212,959,067</b>	<b>231,196,960</b>
	63	Ndryshimi i gjendjes së inventarit	18,237,892	4,320,673

Analitiket për çdo njësi varësie paraqiten si më poshtë:

STRUKTURA LLOGARIA	E M Ë R T I M I	NDRYSHIMI			GJENDJA 31.12.2024
		GJENDJA 01.01.2024	SHTESA	PAKËSIME	
<b>BASHKIA</b>					
3120100	Materiale zyre e të përgjithshme	3,126,519	5,612,713	6,732,432	2,006,800
3121100	Materiale speciale	214,140	7,808,908	6,863,428	1,159,620
3122100	Lëndë djegëse e të ngjashme	1,925,413	10,837,381	8,310,361	4,452,433
<b>TOTAL 312</b>		<b>5,266,072</b>	<b>24,259,002</b>	<b>21,906,221</b>	<b>7,618,853</b>
3270100	Objekte inventari të përgjithshëm	6,441,179	7,822,108	1,409,564	12,853,723
3270200	Objekte inventari speciale	1,425,300			1,425,300
<b>TOTAL 327</b>		<b>7,866,479</b>	<b>7,822,108</b>	<b>1,409,564</b>	<b>14,279,023</b>
<b>TOTALI BASHKIA</b>		<b>13,132,551</b>	<b>32,081,110</b>	<b>23,315,785</b>	<b>21,897,877</b>
<b>NSHMAÇ</b>					
3120100	Materiale zyre e të përgjithshme	8,672,325	32,816,288	30,123,223	11,365,390
3122100	Lëndë djegëse e të ngjashme	4,672,024	37,260,161	29,902,539	12,029,646
<b>TOTAL 312</b>		<b>13,344,349</b>	<b>70,076,449</b>	<b>60,025,762</b>	<b>23,395,036</b>
3270100	Objekte inventari të përgjithshëm	32,145,850	750,016	1,295,222	31,600,644
<b>TOTAL 327</b>		<b>32,145,850</b>	<b>750,016</b>	<b>1,295,222</b>	<b>31,600,644</b>
<b>TOTALI NSHMAÇ</b>		<b>45,490,199</b>	<b>70,826,465</b>	<b>61,320,984</b>	<b>54,995,680</b>
<b>KLUBI SHUMËSPORTËSH</b>					
3120100	Materiale zyre e të përgjithshme	516,627	881,985	612,201	786,411
3122100	Lëndë djegëse e të ngjashme	91,199	91,733	116,977	65,955
<b>TOTAL 312</b>		<b>607,826</b>	<b>973,718</b>	<b>729,178</b>	<b>852,366</b>
3270100	Objekte inventari të përgjithshëm	4,058,785	1,411,648	1,289,647	4,180,786
<b>TOTAL 327</b>		<b>4,058,785</b>	<b>1,411,648</b>	<b>1,289,647</b>	<b>4,180,786</b>
<b>TOTALI KLUBI SHUMËSPORTËSH</b>		<b>4,666,611</b>	<b>2,385,366</b>	<b>2,018,825</b>	<b>5,033,152</b>
<b>QAK</b>					
3120100	Materiale zyre e të përgjithshme	798,235	6,640,795	5,991,053	1,447,977
<b>TOTAL 312</b>		<b>798,235</b>	<b>6,640,795</b>	<b>5,991,053</b>	<b>1,447,977</b>
3270200	Objekte inventari speciale	9,893,154	563,100	3,748,407	6,707,847
<b>TOTAL 327</b>		<b>9,893,154</b>	<b>563,100</b>	<b>3,748,407</b>	<b>6,707,847</b>
<b>TOTALI QAK</b>		<b>10,691,389</b>	<b>7,203,895</b>	<b>9,739,460</b>	<b>8,155,824</b>
<b>QDZH</b>					
3120100	Materiale zyre e të përgjithshme	23,558	496,898	160,519	359,937
3121100	Materiale speciale	521,719	944,820	1,039,137	427,402
3122100	Lëndë djegëse e të ngjashme	667,693	417,251	702,874	382,070
<b>TOTAL 312</b>		<b>1,212,970</b>	<b>1,858,969</b>	<b>1,902,530</b>	<b>1,169,409</b>
3270100	Objekte inventari të përgjithshëm	520,081	22,300	2,500	539,881
<b>TOTAL 327</b>		<b>520,081</b>	<b>22,300</b>	<b>2,500</b>	<b>539,881</b>
3420100	Produkte të gatshme	1,080,100	16,200	2,500	1,093,800
<b>TOTAL 342</b>		<b>1,080,100</b>	<b>16,200</b>	<b>2,500</b>	<b>1,093,800</b>
<b>TOTALI QDZH</b>		<b>2,813,151</b>	<b>1,897,469</b>	<b>1,907,530</b>	<b>2,803,090</b>
<b>QRZH</b>					
3120100	Materiale zyre e të përgjithshme	67,688	579,256	315,524	331,420
3121100	Materiale speciale	249,557	7,603,309	6,519,553	1,333,313
3122100	Lëndë djegëse e të ngjashme	483,824	1,076,060	634,846	925,038
<b>TOTAL 312</b>		<b>801,069</b>	<b>9,258,625</b>	<b>7,469,923</b>	<b>2,589,771</b>
3270100	Objekte inventari të përgjithshëm	2,208,637	911,120	1,146,873	1,972,884
3270200	Objekte inventari speciale	76,200	72,917	90,947	58,170
<b>TOTAL 327</b>		<b>2,284,837</b>	<b>984,037</b>	<b>1,237,820</b>	<b>2,031,054</b>
<b>TOTALI QRZH</b>		<b>3,085,906</b>	<b>10,242,662</b>	<b>8,707,743</b>	<b>4,620,825</b>
<b>SHTËPIA E FOSHNJËS</b>					
3120100	Materiale zyre e të përgjithshme	2,402,213	6,009,897	4,804,426	3,607,684
<b>TOTAL 312</b>		<b>2,402,213</b>	<b>6,009,897</b>	<b>4,804,426</b>	<b>3,607,684</b>
3270100	Objekte inventari të përgjithshëm	4,820,464	2,473,421	4,946,842	2,347,043
<b>TOTAL 327</b>		<b>4,820,464</b>	<b>2,473,421</b>	<b>4,946,842</b>	<b>2,347,043</b>
<b>TOTALI QDZH</b>		<b>7,222,677</b>	<b>8,483,318</b>	<b>9,751,268</b>	<b>5,954,727</b>
<b>NSHP</b>					
3110100	Materiale të para	59,595,031	122,735,407	136,556,209	45,774,229
<b>TOTAL 312</b>		<b>59,595,031</b>	<b>122,735,407</b>	<b>136,556,209</b>	<b>45,774,229</b>

3270100	Objekte inventari të përgjithshëm	76,090,110	6,273,545	27,700,256	54,663,399
<b>TOTAL 327</b>		<b>76,090,110</b>	<b>6,273,545</b>	<b>27,700,256</b>	<b>54,663,399</b>
3410100	Produkte të ndërmjetme	8,409,335	10,924,300	10,273,370	9,060,265
<b>TOTAL 341</b>		<b>8,409,335</b>	<b>10,924,300</b>	<b>10,273,370</b>	<b>9,060,265</b>
<b>TOTALI NSHP</b>		<b>144,094,476</b>	<b>139,933,252</b>	<b>174,529,835</b>	<b>109,497,893</b>
<b>TOTAL 31</b>		<b>84,027,765</b>	<b>241,812,862</b>	<b>239,385,302</b>	<b>86,455,325</b>
<b>TOTAL 32</b>		<b>137,679,760</b>	<b>20,300,175</b>	<b>41,630,258</b>	<b>116,349,677</b>
<b>TOTAL 34</b>		<b>9,489,435</b>	<b>10,940,500</b>	<b>10,275,870</b>	<b>10,154,065</b>
<b>TOTAL</b>		<b>231,196,960</b>	<b>273,053,537</b>	<b>291,291,430</b>	<b>212,959,068</b>
Ndryshimi i gjendjes					<b>18,237,892</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë.

**Mbi verifikimi i regjistrimeve kontabël dhe mbështetja në dokumentacionin justifikues në ndërtimin e pasqyrave financiare;**

**Llogaritë e klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhen nga:**

Lekë

Gjendja e llogarive të Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” më datë 31.12.2024, në pasqyrat financiare të konsoliduara				
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023
31	Materiale	86,455,325	84,027,765	2,427,560
32	Inventar i imët	116,349,677	137,679,760	(21,330,083)
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0	0
34	Produkte	10,154,065	9,489,435	664,630
35	Mallra	0	0	0
36	Kafshë në rritje e majmëri	0	0	0
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provizione për zhvlerësimin e inventarit (-)	0	0	0
Totali		212,959,067	231,196,960	(18,237,893)

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë.

Llogaritë e Klasës 3 sipas pasqyrës së pozicionit financiar të bilancit të konsoliduar më datë 31.12.2024, paraqiten në vlerën 212,959,067 lekë dhe përbëhen nga llogaritë kontabël 31 “Materiale” në vlerën 86,455,325 lekë, 32 “Inventar i imët” në vlerën 116,349,677 lekë dhe 34 “Produkte” në vlerën 10,154,065 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në vlerën 18,237,893 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” e cila paraqitet në vlerën 18,237,892 lekë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 4.1.

- **Llogaria 31 “Materiale”** ka vlerën 86,455,325 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2024	84,027,765
Shtesa (D)	241,812,862
Pakësime (K)	239,385,302
Gjendja në 31.12.2024	86,455,325

- **Llogaria 32 “Inventarë i imët”** ka vlerën 116,349,677 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2024	137,679,760
Shtesa (K)	20,300,175
Pakësime (D)	41,630,258
Gjendja në 31.12.2024	116,349,677

- **Llogaria 34 “Produkte”** ka vlerën 10,154,065 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2024	9,489,435
Shtesa (K)	10,940,500
Pakësime (D)	10,275,870
Gjendja në 31.12.2024	10,154,065

Pakësimet si rezultat i nxjerrjes jashtë i përkasin llogarisë 32, për vitin 2024 pakësimet e llogarisë 32 janë në vlerën 41,630,258 lekë nga të cilat, vlera 32,479, 035 lekë janë aktive jashtë përdorimit të detajuara si më poshtë:

EMËRTIMI	PAKËSIMET
	Jashtë Përdorimi
Aparati	253,297
NSHMAÇ	777,075
QAK	3,748,407
NSHP	27,700,256
<b>TOTAL</b>	<b>32,479,035</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë.

### **Cikli i regjistrimeve kontabël dhe mbështetja në dokumentacionin justifikues për ndërtimin bartësve të informacionit kontabël në hartimin e pasqyrave financiare;**

Për ndërtimin e bilancit të konsoliduar dhe të pasqyrave financiare të njëjësive vartëse, institucioni duhet të sigurojë që regjistrimet kontabël të jenë kryer në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e raportimit financiar, duke garantuar saktësinë, plotësinë dhe pandryshueshmërinë e tyre. Në këtë kuadër, gjatë ndërtimit të bilancit të konsoliduar është e domosdoshme që të realizohen testime dhe verifikime të drejtpërdrejta mbi regjistrimet në ditarët kontabël, për të vlerësuar nëse ato përmbushin kriteret e mëposhtme:

- Mbështetja në dokumente justifikuese: çdo regjistrim duhet të mbështetet në dokumentacion origjinal, të verifikuar për vlefshmëri ligjore dhe kontabël, që mundëson pranimin e tij në kontabilitet (*vlerësim kontabël i saktë*);
- Pandryshueshmëria e regjistrimeve: regjistrimet e kryera dhe bartësit përkatës (*mandate, fletë-hyrje/dalje, ditarë, kartela llogarish*) nuk duhet të ndryshohen pa bazë ligjore dhe pa gjurmë audituese;
- Tërësia dhe kronologjia: të gjitha regjistrimet duhet të jenë të plota, të renditura në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbylljen e ushtrimit financiar, duke siguruar vazhdimësi logjike të të dhënave në të gjithë ciklin kontabël.

Gjithashtu, informacioni kontabël duhet të mundësojë kontrollin rrjedhës dhe kontrollin e mëvonshëm në të gjitha fazat e tij, përmes këtyre mekanizmave:

- Krahasimi i regjistrimeve me dokumentet bazë: vlefshmëria e çdo regjistrimi fillestar duhet të vërtetohet duke e krahasuar me dokumentin justifikues përkatës (*mandat pagese, fletë-hyrje, faturë, urdhër-xhirim etj.*);
- Verifikimi i konsistencës së dokumenteve: çdo dokument i përdorur për regjistrim kontabël duhet të kontrollohet për përputhshmëri me dokumentet bazë mbi të cilat është përgatitur;
- Kontroll aritmetik dhe kontabël: shumat e regjistruara në mënyrë kronologjike në ditarë duhet të përputhen me lëvizjet në librin e llogarive dhe me pasqyrat përmbyllëse të ushtrimit (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive), duke garantuar përputhshmërinë aritmetike dhe kontabël të të dhënave.

Nga auditimi i pasqyrave lidhur me ndryshimin e gjendjes së inventarit si rezultat i lëvizjeve të materialeve, inventarit dhe produkteve për vitin 2024 u konstatua se, gjatë periudhës së ushtrimit financiar, shtesat dhe pakësimet kanë shënuar vlera të konsiderueshme si në nivel absolut, ashtu edhe në përqindje ndaj gjendjes fillestare(çeljes) të vitit.

### **Shtesat më të larta në vlerë absolute janë regjistruar në:**

- Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike (NSHP) me 139,933,252 lekë, të përbëra kryesisht nga:

- 122,735,407 lekë në llogarinë 3110100 – Materiale të para;
  - 10,924,300 lekë në llogarinë 3410100 – Produkte të ndërmjetme;
  - 6,273,545 lekë në llogarinë 3270100 – Objekte inventari të përgjithshëm.
- Ndërmarrjen e Shërbimeve Mbështetëse (NSHMAÇ) me 70,826,465 lekë, kryesisht në:
- 37,260,161 lekë në llogarinë 3122100 – Lëndë djegëse e të ngjashme;
  - 32,816,288 lekë në llogarinë 3120100 – Materiale zyre e të përgjithshme;
  - 750,016 lekë në llogarinë 3270100 – Inventar.

- Bashkia (Aparati) me 32,081,110 lekë, ku dominon rritja në:
  - 10,837,381 lekë në llogarinë 3122100 – Lëndë djegëse e të ngjashme;
  - 7,808,908 lekë në llogarinë 3121100 – Materiale speciale;
  - 7,822,108 lekë në llogarinë 3270100 – Inventar;
  - 5,612,713 lekë në llogarinë 3120100 – Materiale zyre e të përgjithshme.

#### **Në përqindje ndaj gjendjes fillestare, shtesat më të larta janë:**

- Qendra Rezidenciale e Zhvillimit (QRZH):  $10,242,662 / 3,085,906 = 332\%$ : (Shtesa ÷ Gjendja 01.01.2024) × 100)
- Bashkia Aparati:  $32,081,110 / 13,132,551 = 244\%$
- NSHMAÇ:  $70,826,465 / 45,490,199 = 156\%$

#### **Pakësimet më të mëdha në vlerë absolute janë regjistruar në:**

- Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike (NSHP) me 174,529,835 lekë, të përbëra nga:
  - 136,556,209 lekë në llogarinë 3110100 – Materiale të para;
  - 27,700,256 lekë në llogarinë 3270100 – Inventar;
  - 10,273,370 lekë në llogarinë 3410100 – Produkte të ndërmjetme.
- Ndërmarrjen e Shërbimeve Mbështetëse (NSHMAÇ) me 61,320,984 lekë, përbërë nga:
  - 30,123,223 lekë në llogarinë 3120100;
  - 29,902,539 lekë në llogarinë 3122100;
  - 1,295,222 lekë në llogarinë 3270100.
- Bashkia (Aparati) me 23,315,785 lekë, përfshirë:
  - 8,310,361 lekë në llogarinë 3122100;
  - 6,863,428 lekë në llogarinë 3121100;
  - 6,732,432 lekë në llogarinë 3120100;
  - 1,409,564 lekë në llogarinë 3270100.

#### **Në përqindje ndaj gjendjes fillestare, pakësimet më të larta janë:**

- QRZH:  $8,707,743 / 3,085,906 = 282\%$
- Bashkia qendrore:  $23,315,785 / 13,132,551 = 178\%$
- NSHMAÇ:  $61,320,984 / 45,490,199 = 135\%$
- NSHP:  $174,529,835 / 144,094,476 = 121\%$

Nga shqyrtimi i bartësve të informacionit kontabël (*mandate arkëtimi, mandate pagese, fletë-hyrje, fletë-dalje, ditarë, kartela artikujsh, libër i magazinës, ditar i shpenzimeve, ditar banke, libër i llogarive, pasqyrat financiare etj.*) rezultoi ngjarjet përgjithësisht janë pasqyruar në pasqyrat financiare por ky institucion nuk ka mbajtur të plotë ciklin e regjistrimeve kontabël dhe të magazinës. Në ditarin e magazinës, regjistrimet për hyrjet nuk përmbajnë të dhëna të detajuara mbi produktet/artikujt e blera (emërtim, sasi, vlerë, subjekt, datë, origjinë), por vetëm datën dhe emrin e furnitorit, gjithashtu pjesë e informacionit të këtij bartësi është edhe veprimi kontabël mbi llogaritë përkatëse – një praktikë që i përket një faze tjetër të ciklit kontabël. E njëjta mangësi është konstatuar edhe për daljet, ku mungojnë të dhëna mbi produktin/artikullin e dalë, sasinë, kërkesën mbi të cilën është bërë dalja dhe destinacionin përfundimtar të produktit. Pra në të gjitha raste, hyrjet dhe daljet janë regjistruar drejtpërdrejt në ditarin e shpenzimeve, duke kryer

njëkohësisht veprim kontabël mbi llogaritë përkatëse – një praktikë që i përket një faze tjetër të ciklit kontabël.

Njësitë vartëse nuk kanë dokumentuar kontrollet periodike të magazinës dhe asnjë rakordim mujor midis kartelave të magazinës dhe regjistrimeve kontabël. Bashkia, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, nuk ka kërkuar raporte krahasuese të shtesave dhe pakësimeve me shpjegime për ndryshimet me vlera të larta.

Në dokumentacionin e vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultojnë procesverbale inventarizimi fizik dhe rakordim me atë kontabël, por në gjithë fazat e ciklit kontabël (*libër i magazinës, ditar i shpenzimeve, ditar banke, libër i llogarive, pasqyrat financiare etj*) nuk u konstatuan të dhëna apo relacione konkrete të cilat japin informacion mbi shtesën apo pakësimin e artikujve konkrete përveç informacioneve të përmendura më sipër, konkretisht:

- Për hyrjet në magazinë konstatohet vetëm informacion mbi datën, emrin e furnitorit edhe veprimi kontabël mbi llogaritë përkatëse.
- Për daljet nga mangazina konstatohet vetëm informacion mbi datën, emrin e personit që e tërheq edhe veprimi kontabël mbi llogaritë përkatëse.

Duke marrë në konsideratë se:

- Për hyrjet në magazinë duhet:

1. Plotësimi i fletë-hyrjes mbasi është realizuar blerja dhe mallrat janë marrë në dorëzim nga komisioni dhe i shtohen zërave të magazinës.

Ky informacion i cili përmban të dhënat identifikuese lidhur me produktin/artikullin e blerë, konkretisht emërtim, sasi, vlerë, subjekt furnitor, datë, origjinë është shumë i rëndësishëm **për përcaktimin e inventarit kontabël lidhur me shtesat.**

Të dhënat e domosdoshme për plotësimin të bartësit të informacionit kontabël dhe një ndër formatet e përshtatshme të një ditari magazine për hyrjet paraqiten në pasqyrën më poshtë:

Pasqyra me të dhënat e domosdoshme të një ditari magazine;

F.H. NR	DATA	Përshkrimi	ARTIKULLI	NJESIA	SASIA	VLEFTA	TOTALI	ORIGJINA	Te dhena te tjera
1	04.12.2024	Dhurim materiale te ndryshme	BAZAMENT BETONI	cope	100	0	0	Kontratë DHURIMI NR.383 PROT. DT.29/05/2024	
2	04.12.2024	Blerje Sinjalistike	Shtylla Metalike	cope	60	12600	756000	Kontrate Blerje Sinjalistike për hapësirat publike, Nr Prot 234/12, Dt 12.06.2024	
3	10.12.2024	Blerje Sinjalistike	Krahe per koka ndricimi	cope	60	2400	144000	Kontrate Blerje Sinjalistike për hapësirat publike, Nr Prot 234/12, Dt 12.06.2024	
4	16.12.2024	Blerje Materiale Pastrimi	Acid per Pastrim	cope	90	144	12960	Kontrate Blerje Materiale Pastrimi, Nr Prot 382/11, Dt 28.07.2024	
5	17.12.2024	Blerje Materiale Pastrimi	Xhel Dezinfektues	cope	73	240	17520	Kontrate Blerje Materiale Pastrimi, Nr Prot 382/11, Dt 28.07.2024	
6	Anulluar	Blerje Materiale Ndertimi	Cakell per mbushje	m3	130	420	54600	Kontrate Blerje Materiale Ndertimi, Nr Prot 400/14, Dt 10.09.2024	
7	19.12.2024	Blerje Materiale Ndertimi	Beton 1 gatshem c20/25 me cakell	m3	62	8880	550560	Kontrate Blerje Materiale Ndertimi, Nr Prot 400/14, Dt 10.09.2024	
8	23.12.2024	Blerje Koshash/Kazanë pastrimi	Kazan mbeturinash metalik	cope	60	40800	2448000	Kontrate Blerje Koshash, Nr Prot 400/14, Dt 10.09.2024	
9	23.12.2024	Blerje Koshash/Kazanë pastrimi	Kazan mbeturinash plastik	cope	60	27600	1656000	Kontrate Blerje Koshash, Nr Prot 400/14, Dt 10.09.2024	

Pasqyra e një ditari magazine të njësisë sipas të dhënave të marra në shqyrtim nga grupi i auditimit është:

**Aparati**

F.H. NR	DATA	Përshkrimi	DEBI					45	KREDI		
			312		218				K 630	101	45
			3120000	3121100	2187100	2186100	2140290				
			M.Z.te pegj	M.Spec	Te tjera	Kompju	Pj aud-viz				
129	04.12.2024	Sh. D.	xxxxxxx						xxxx	xxx!	-
130	04.12.2024	N. SHPK							xxxx	xxx	-
131	04.12.2024	Y. M.		xxxxxxx					xxxxxx	xxxx	-
132	10.12.2024	T. G.	xxxxxx						xxxx	xxxx	-
133	13.12.2024	I.C.C. Group shpk	xx			1,538,500.00	468,000.00	150,000.00	xxxxx	xxxx	-
134	13.12.2024	M. Sh.			xxxxx				xxxx	xxxx	-

Klubi Shumë sportësh:

F.H. NR	DATA	Përshkrimi	214		312		327		K 630 ndryshimi I gjendjeve te inventarit	101 fonde baze	45 maredhenie me institucionet brenda dhe jashte sistemit
			214 reja	214 perdorura	312 reja	312 perdorura	327 reja	327 perdorura			
71	08.11.2024	B. F. mat hidraulike			49,900				49,900	0	
72	14.11.2024	Vboll meshk E. M.						4,800	4,800	0	
73	14.11.2024	Vboll meshk S. K.						4,800	4,800	0	
74	14.11.2024	Vboll meshk M. M.						4,800	4,800	0	

- Për daljet nga mangazina hapat që ndiqen janë:

1. Plotësimi i dokumentacionit mbështetës për tërheqjen, konkretisht:

- Kërkesa e plotësuar dhe nënshkruar nga sektori ose drejtorja për tërheqjen e produktit/artikullit sipas nevojës që kanë për produkte/artikuj.
- Urdhër veprimi i protokolluar i miratuar nga NZ dhe NA (*ose personi të cilit i delegohet kjo kompetencë*). Ky dokument autorizon personin përgjegjës për mangazinën që bazuar në këtë urdhër veprim të vendosen në dispozicion produktet/mallrat për plotësimin e nevojave të sektorit/drejtorisë që ka paraqitur në kërkesë.

2. Plotësimi i fletë-daljes mbasi është konfirmuar nga mangazineri plotësimi i dokumentacionit mbështetës për daljen dhe dorëzimi i produktit/artikullit të kërkuar.

Mangazina pas plotësimit të fletë-daljes kryen pakësimin e zërave të mangazinës për produktin/artikullin e përshkruar në fletë-dalje.

3. Pjesë e dokumentacionit të mangazinës behet edhe një kopje e proces-verbalit të marrjes në dorëzim ose dokumentacioni i cili vërteton destinacionin final ku ka shkuar produkti/artikulli.

Ky informacion i cili përmban të dhënat identifikuese lidhur me produktin/artikullin e dalë nga mangazina për plotësimin e nevojave të njësisë, konkretisht emërtim, sasi, vlerë, destinacionin, datë, është shumë i rëndësishëm **për përcaktimin e inventarit kontabël lidhur me pakësimet.**

Të dhënat e domosdoshme dhe një ndër formatet e përshtatshme të një ditari magazine për hyrjet paraqiten në pasqyrën më poshtë:

Pasqyra me të dhënat e domosdoshme të një ditari magazine;

Ditari i daljeve të mangazinës													
Kërkesa nr.prot	Urdhër veprimi nr. prot	Datë	F.D. NR	DATA	Përshkrimi	ARTIKULLI	NJESIA	SASIA	VLEFTA	TOTALI	Destinacioni	Procc verbal i dorezimi nr.	Datë
1	1	09.06.2024	1	04.12.2024	Dalje materiale te ndryshme	BAZAMENT BETONI	cope	0	0	0	xxxx	1	xxxx
2	2	09.06.2024	2	04.12.2024	Dalje materiale Sinjalistike	Shtylla Metalike	cope	0	12600	0	xxxx	2	
3	3	09.06.2024	3	10.12.2024	Dalje materiale Sinjalistike	Krahe per koka ndricimi	cope	0	2400	0	xxxx	3	
4	4	09.06.2024	4	16.12.2024	Dalje Materiale Pastrimi	Acid per Pastrim	cope	0	144	0	xxxx	4	
5	5	09.06.2024	5	17.12.2024	Dalje Materiale Pastrimi	Xhel Dezinfektues	cope	0	240	0	xxxx	5	
6	6	09.06.2024	6	Anulluar	Dalje Materiale Ndertimi	Cakell per mbushje	m3	0	420	0	xxxx	6	
7	7	09.06.2024	7	19.12.2024	Dalje Materiale Ndertimi	Beton I gatshem c20/25 me cakell	m3	0	8880	0	xxxx	7	
8	8	09.06.2024	8	23.12.2024	Dalje Koshash/Kazanë pastrimi	Kazan mbeturinash metalik	cope	0	40800	0	xxxx	8	
9	9	09.06.2024	9	23.12.2024	Dalje Koshash/Kazanë pastrimi	Kazan mbeturinash plastik	cope	0	27600	0	xxxx	9	

Pasqyra e një ditari magazine të njësisë sipas të dhënave të marra në shqyrtim nga grupi i auditimit është:

Aparati;

F.D. NR	DATA	Pershkrimi	D					K				
			630	218	211	etj	45	312	211	218	45	
754	04.12.2024	Xh. K.	8,633.31					8,633.31				
755	04.12.2024	A. L.			3,741,477.60				3,741,477.60			
756	04.12.2024	I. J.	43,200.00					43,200.00				
757	04.12.2024	B. M.		9,600.00							9,600.00	
758	04.12.2024	G. H.	4,320.79					4,320.79				
759	04.12.2024	M. P.			73,200.00						73,200.00	
760	05.12.2024	K. T.	1,800.00					1,800.00				

**Konkluzion:** Regjistrimi i plotë në ditarin e magazinës mbi Hyrjet (*shtesat e produkteve/artikujve*) dhe daljet (*pakësimet e produkteve/artikujve*) e produkteve/artikujve në magazinë janë procesi i cili përcakton qarkullimin e inventarëve pra gjendjen e inventarit kontabël të njësisë. Inventari kontabël si pjesë përbërëse procesit të inventarizimit vjetor që kryhet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ka në thelb rakordimin midis inventarizimit fizik dhe kontabël. Nëse informacioni i nevojshëm për përcaktimin e inventarit kontabël ndalon së pasqyruari (*mbartur*) në të dhënat të cilat gjendjen vetëm në fazat fillestare të blerjes (*faturë blerje, marje në dorëzim fletë hyrje dhe fletë dalje*) atëherë të dhënat e paraqitura në procesverbalet e inventarizimit mbi rakordimin kontabël me inventarin fizik paraqesin risk dhe mungesë të gjurmës së auditimit. Sa më sipër e bën të pamundur të përcaktohet me saktësi dhe konform kuadrin regullator sasia kontabël e materialeve në fund të vitit financiar.

Sipas Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, dhe udhëzimit 30 njësitë e qeverisjes vendore kanë për detyrë të evidentojnë lëvizjet e materialeve, inventarit dhe produkteve në mënyrë kronologjike dhe të dokumentuar, duke siguruar përputhje ndërmjet regjistrimeve kontabël dhe inventarit fizik. Çdo transaksion duhet të mbështetet në bartësit e informacionit kontabël përkatës (mandate, fletë-hyrje/dalje, ditarë, libra kontabël etj.), në përputhje me sistemin e llogarive buxhetore të miratuar nga Ministria e Financave.

Mosmbajtja e ciklit të plotë të bartësve të informacionit kontabël, mungesa e detajimit të hyrjeve dhe daljeve në regjistrat e magazinës, dhe mospërfshirja e kontrolleve mujore dhe inventarizimit fizik, krijojnë risk të lartë për mosrakordim midis pasqyrave financiare dhe inventarit fizik, mospërputhje ndërmjet vlerës kontabël dhe ekzistencës reale të aseteve, si dhe pamundësi për verifikim të plotësisë dhe saktësisë së transaksioneve.

Në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi ky institucion duhej të kish marrë masa që:

1. Për çdo veprim financiar dhe material të kryente monitorimin mbi mbajtjen dhe plotësimin korrekt të gjithë bartësve të informacionit kontabël sipas strukturave të miratuara duke i dhënë rëndësi plotësimi të çdo bartësi me informacionin për të cilin ky bartës është krijuar dhe duke shmangur bashkimin e tyre;
2. Të rishikohet mënyra e përdorimit të ditarit të magazinës vetëm për të dhëna që ndihmojnë funksionimin e njësisë, duke siguruar që çdo hyrje dhe dalje të shoqërohet me të dhëna të detajuara mbi artikullin, sasinë, datën, kërkesën dhe destinacionin;
3. Të kryente nëpërmjet strukturave përgjegjëse kontrolle të brendshme periodike për rakordimin mujor të magazinës me librat kontabël;
4. Të kërkonte raporte krahasuese të shtesave dhe pakësimeve nga çdo njësi vartëse, me analiza shpjeguese për ndryshimet e mëdha;

#### **Pasqyra e performancës financiare;**

Pasqyra e performancës financiare përbën një nga komponentët bazë të paketës së pasqyrave financiare vjetore të njësisë të qeverisjes së përgjithshme. Kjo pasqyrë paraqet në mënyrë të klasifikuar, të strukturuar dhe krahasuese të dhënat që lidhen me të ardhurat, shpenzimet dhe rezultatin financiar të periudhës ushtrimore, duke reflektuar në mënyrë të drejtë e të saktë performancën ekonomiko-financiare të njësisë për vitin përkatës krahasuar me vitin paraardhës. Gjithashtu, pasqyra përfshin efektet e ndryshimit të gjendjes së inventarit, të cilat evidentohen përmes llogarive 63, 101 dhe 8423, në përputhje me kërkesat e udhëzimit.

Auditimi i kësaj pasqyre synon të verifikojë besueshmërinë dhe integritetin e informacionit financiar të raportuar, si dhe përputhshmërinë e tij me të dhënat e sistemit informatik të Thesarit (SIFQ).

Në zbatim të kërkesave të Udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar, përpara përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare, njësia është e detyruar të

rakordojë të ardhurat dhe shpenzimet me degën e thesarit përmes dokumentit të akt-rakordimit, duke siguruar që çdo transaksion i regjistruar në kontabilitet pasqyron saktë lëvizjet monetare të evidentuara në sistemin e Thesarit.

Në këtë pasqyrë, informacioni paraqitet në dy rubrika kryesore:

- Rubrika A – **Të ardhurat**, ku evidentohen të gjitha burimet e të ardhurave sipas natyrës së tyre (tatimore, jotatimore, financiare, grante, etj.);
- Rubrika B – **Shpenzimet**, ku përfshihen të gjitha shpenzimet e kryera gjatë periudhës ushtrimore sipas klasifikimit ekonomik (paga, kontribute, mallra e shërbime, subvencione, transferime, amortizim, etj.);
- Rubrika C pasqyron **rezultatit financiar** të vitit (tepricë ose deficit), që përbën ndryshimin neto ndërmjet totalit të të ardhurave dhe totalit të shpenzimeve.

Procesi i auditimit mbi pasqyrën e performancës financiare përqendrohet në:

1. Verifikimin e plotësisë dhe saktësisë së regjistrimeve në raport me evidencat kontabël dhe akt rakordimet dhe situacionet e Thesarit;
2. Testimin e transaksioneve të të ardhurave dhe shpenzimeve për të vlerësuar ekzistencën, saktësinë dhe vlerësimin e tyre;
3. Vlerësimin e rakordimit ndërmjet kontabilitetit të njësisë dhe SIFQ-së për të siguruar që diferencat e mundshme janë justifikuar dhe korrigjuar;
4. Përputhjen ndërmjet rezultatit të pasqyrës së performancës (Rubrika C) dhe llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në pasqyrën e pozicionit financiar.

Nëpërmjet këtij procesi, grupi i auditimit synon të arrijë një konkluzion nëse pasqyra e performancës financiare jep një paraqitje të vërtetë dhe të drejtë të gjendjes financiare dhe të rezultatit të veprimtarisë ushtrimore, në përputhje me parimet e raportimit financiar të përcaktuara në udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

#### **Nga ky proces rezulton se:**

Struktura standarte e formularit “Formati nr. 2” është hartuar duke respektuar ndarjen funksionale në:

#### **A. Të Ardhurat**, sipas nënkategorive, konkretisht:

*Të ardhurat nga Taksat dhe Tatimet, Kontribute Sigurime Shoqërore e Shëndetësore;*

*Të Ardhura Jo Tatimore;*

*Të Ardhura Financiare;*

*Grante Korente;*

*Të Ardhura të tjera;*

*Ndryshimi i gjendjes së inventarit ekonomik.*

#### **B. Shpenzimet** sipas nënkategorive, konkretisht:

*Pagat dhe Përfitimet e Punonjësve;*

*Kontribute të Sigurimeve Shoqërore Shëndetësore;*

*Blerje Mallra e Shërbime;*

*Subvecione;*

*Transferime Korente;*

*Shpenzime Financiare;*

*Kuota Amortizimi dhe Shuma të Parashikuara;*

*Ndryshimi i Gjendjes së Inventarit;*

*Shpenzime të tjera;*

#### **C. Rezultatit të veprimtarisë ushtrimore;**

*Teprica ose Deficiti i Periudhës (Rezultati i Veprimtarisë së Vitit Ushtrimor);*

Struktura e hartuar është plotësuar me referencim të qartë të llogarive buxhetore përbërëse sipas planit të llogarive me informacion mbi periudhën ushtrimore dhe atë paraardhëse, në përputhje me

kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi. Respektivisht të dhënat sipas ndarjes funksionale paraqiten në tabelën më poshtë:

Pasqyra e performancës financiare të dhënat sipas ndarjes funksionale në lekë;

Nr.	Reference llogarive	Përshkrimi i operacioneve	Viti ushtrimor	Viti i mëparshëm
1	<b>A</b>	<b>TE ARDHURAT</b>	<b>3,862,723,270</b>	<b>3,603,283,060</b>
2	70	I.Te ardhurat nga taksat e tatimet	397,793,521	384,316,883
3	75	II.Kontribute sig.e shoq.e shend.	0	0
4	71	III.Te ardhura jo tatimore	278,385,537	262,766,550
5	76	IV.Te ardhura financiare	0	0
6	72	V.Grante korente	3,076,683,118	2,796,624,287
7		VI.Te ardhura te tjera	109,861,095	159,575,339
8	73	VII.Ndryshimi i gjendjes se inventarëve. të prod.	0	0
9	<b>B</b>	<b>SHPENZIMET</b>	<b>3,694,310,055</b>	<b>3,452,118,286</b>
10	600	I.Pagat dhe perfitimet e punonjseve	839,497,467	759,234,673
11	601	II.Kontribute te sigurimeve	139,941,540	125,632,951
12	602	III.Blerje mallra e sherbime	726,423,992	611,732,381
13	603	IV.Subvecione	10,200,795	10,626,143
14		V.Transferime korente	1,870,494,162	1,796,345,085
15		VI.Shpenzime financiare	868,449	2,827,855
16		VII.Kuota amort. dhe shuma te parash.	0	0
17	63	VIII.Ndryshimi i gjendjes se inventarit	18,237,892	4,320,673
18		IX.Shpenzime te tjera	88,645,758	141,398,525
19	<b>85</b>	<b>TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUHES</b>	<b>168,413,216</b>	<b>143,149,845</b>
20		(Rezultati i veprimtarise se vitit ushtrimor)	0	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë.

#### **A. Për kontabilizimin e të ardhurave:**

**Për vitin 2024 u krye** analiza e burimeve të të ardhurave (tatimore, jotatimore, grante etj, për të përcaktuar ngjarjet që kanë ndodhur gjatë periudhës ushtrimore dhe për tu siguruar nëse ato janë pasqyruar të plota nëpërmjet regjistrimeve në kontabilitet. Si rezultat i testeve më sipër

<b>LLOGARIA 7020</b>		
7020100	Tatim mbi tokën bujqësore	26,431,706.21
7020200	Tatim mbi ndërtesën	131,333,113.05
<b>TOTALI</b>		<b>157,764,819.26</b>

Nga verifikimi i regjistrimeve në ditarët kontabël dhe i llogarive të të ardhurave rezultojnë kontabilizimi i tyre është kryer në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 8/2018, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 5/2022. Regjistrimet janë mbështetur në dokumente justifikuese të vlefshme dhe të verifikuara, nuk paraqesin ndryshime të paautorizuara, si dhe janë kryer në mënyrë kronologjike e sistematike deri në mbylljen e ushtrimit financiar. Krahasimi i regjistrimeve me dokumentet bazë justifikuese dhe barazimi i shumave të ditarëve me lëvizjet në librin e llogarive dëshmon për ekzistencën e kontrollit rrjedhës dhe atij të mëvonshëm.

Shumat e pasqyruara në llogaritë e të ardhurave janë të përputhshme me të dhënat e akt rakordimit me thesarin, konkretisht:

–	Llogaria	7020	regjistron	gjithsej	157,764,819.26	lekë;
–	Llogaria	7035	regjistron	gjithsej	229,373,074.90	lekë;
–	Llogaria	7110	regjistron	gjithsej	197,843,972.00	lekë;
–	Llogaria	7204	regjistron	gjithsej	86,892,669.00	lekë.

Gjithashtu, nga auditimi i llogarisë 7205 për të ardhurat nga veprimtaritë e institucioneve vartëse u konstatua se regjistrimet në këto llogari janë të rakorduar dhe përputhen me akt rakordimin e

thesarit si dhe të mbështetuara në dokumentacion justifikues, ku vlera totale 455,133,814.00 lekë ndahet si vijon:

Bashkia (3,455,262 lekë), NSHMAÇ (100,303,384 lekë), Klubi Shumësportësh (38,839,818 lekë), QAK (69,438,581 lekë), QDZH (806,336 lekë), QRZH (825,010 lekë), Shtëpia e Fëmijës (2,574,050 lekë) dhe NSHP (238,891,373 lekë).

Sa i takon llogarisë 7201, për të cilën u verifikuan fondet buxhetore dhe transfertat, rezulton se totali 2,194,572,575.00 lekë është i mbështetur me vendime, urdhërpagesa dhe dokumente të përcaktuara nga Ministria e Financave.

Nga ky total, Bashkia ka grumbulluar 1,621,180,289 lekë, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga grantet e përdorura nga NSHMAÇ (307,543,410 lekë), Klubi Shumësportësh (12,017,516 lekë), QAK (30,885,264 lekë) dhe NSHP (222,946,096 lekë).

Në mënyrë të ngjashme, vlerat e llogarisë 787 në shumën totale 109,861,095.00 lekë, përfshirë Bashkinë (87,879,462 lekë), NSHMAÇ (14,212,848 lekë), Klubin Shumësportësh (967,748 lekë), QAK (1,883,654 lekë), QRZH (1,336 lekë), Shtëpinë e Foshnjës (354,426 lekë) dhe NSHP (4,561,621 lekë), rezultojnë të dokumentuara, dhe rakordojnë me librat kontabël dhe të regjistruara sipas kërkesave të sistemit të kontabilitetit.

Në përfundim, nga auditimi u konstatua se kontabilizimi i të ardhurave është kryer në mënyrë të rregullt, të dokumentuar dhe në përputhje me parimet e vlefshmërisë, plotësisë dhe pajtueshmërisë kontabël.

Nga auditimi i regjistrimeve kontabël të shpenzimeve rezulton se regjistrimet në ditarët kontabël janë kryer në mënyrë të dokumentuar dhe në përputhje me kërkesat e kuadrit rregulator. Regjistrimet janë mbështetur në dokumente justifikuese dhe janë kryer në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit financiar.

Entitet e Institucioneve	Total 600	6021	6022	6029	Total 6044	6061	(230-231)	(6020,6023,6024,6025,6026,6030)
Bashkia	236,227,810.00	4,275,540.00	186,995,048.80	30,647,057.65	119,759,386.60	600,712,979.00	258,938,381.00	40,565,221.00
NSHMAC	274,017,826.00	22,395,345.00	23,158,904.00	5,429,820.00	2,500,000.00	11,860,928.00	14,631,768.00	60,913,848.00
NSHP	229,945,147.00	102,362,042.00	48,783,309.00	117,481.00	-	733,500.00	16,952,500.00	54,376,703.75
Qendra e Artit dhe kultures	32,136,788.00	2,396,042.00	27,337,816.00	29,973,000.00	-	30,000.00	2,609,135.00	7,347,515.00
Klubi shumësportësh	10,171,705.00	26,018,971.00	3,235,310.00	-	-	52,250.00	204,500.00	10,935,099.00
Qendra ditore e Zhvillimit	6,385,436.00	82,370.00	1,826,392.00	18,945.00	-	60,000.00	-	1,454,803.00
Qendra Rezidenciale e Zhvillimit	21,551,489.00	8,032,651.00	1,705,859.00	478,859.00	-	255,000.00	-	4,076,746.00
Shtëpia e Foshnjës	14,146,555.00	670,312.00	717,461.00	28,740.00	-	135,000.00	-	116,752.00
<b>Total</b>	<b>824,582,756.00</b>	<b>166,233,273.00</b>	<b>293,760,099.80</b>	<b>66,693,902.65</b>	<b>122,259,386.60</b>	<b>613,839,657.00</b>	<b>293336284</b>	<b>179,786,687.75</b>

Analiza e shpërndarjes së shpenzimeve tregon se peshën kryesore të shpenzimeve e mbart Bashkia me 600,712,979 lekë, e ndjekur nga NSHMAÇ me 60,913,848 lekë dhe NSHP me 54,376,703.75 lekë. Shpenzimet më të larta janë të përqendruara në llogaritë 6044 – Shpenzime operative, 6061 – Shpenzime personeli dhe 6022 – Shpenzime të shërbimeve dhe kontratave të ndryshme. Të dhënat e detajuara sipas llogarive (6021, 6022, 6029, 6044, 6061) rezultojnë të rakorduara me librin e llogarive dhe të mbështetura me dokumentacion justifikues të rregullt.

**Sa i përket hartimit të pasqyrës së pozicionit financiar “Formati nr.1” të bilancit të konsoliduar për vitin 2024;**

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar të pasqyrave të konsoliduara të Bashkisë Korçë u konstatua se në raportimin financiar për vitin ushtrimor të mbyllur më 31.12.2024 struktura standarte e formularëve “Formati nr.1” është hartuar duke respektuar ndarjen funksionale në Aktive, Pasive dhe Aktive Neto/Fonde, me referencim të qartë të llogarive buxhetore përbërëse sipas planit të llogarive, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi:

## A. AKTIVET

### I. Aktivet Afat Shkurtra

#### 1. Llogaritë e klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:

Lekë

Gjendja e llogarive të Klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” më datë 31.12.2024, në pasqyrat financiare të konsoliduara				
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023
531	Mjete monetare në arkë	0	0	-
512,56	Mjete monetare në bankë	0	26,540,703	(26,540,703)
520	Disponibilitete në thesar	217,054,059	273,863,300	(56,809,241)
50	Letra me vlerë	0	0	-
532	Vlera të tjera	9,952,638	13,612,577	(3,659,939)
54	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	-
59	Provizione zhvlerësimi letra me vlerë (-)	0	0	-
Totali		227,006,697	314,016,580	(87,009,883)

- **Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”** paraqitet më datë 01.01.2024, në vlerën 273,863,300 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 217,054,059 lekë. Kjo llogari kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 168,413,216 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 48,640,843 lekë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pikat 49-50.

- **Llogaria 532 “Vlera të tjera”** më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 13,612,577 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 9,952,638 lekë me një pakësim në vlerën 3,659,939 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Llogaria 532 “Vlera të tjera”	
Çelje e vitit 2024	13,612,577
Shtesa (D)	12,974,750
Pakësime (K)	16,634,689
<b>Gjendja debitore në 31.12.2024</b>	<b>9,952,638</b>

Lekë

Vlera të tjera	Gjendja 01.01.2024	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2024
Pulla të gjendjes civile	522,000	594,000	963,000	153,000
Bileta parkimi	11,500,000	10,000,000	13,750,000	7,750,000
Vërtetime rajoni	70,000	600,000	380,000	290,000
Vërtetime pyjore	336,000	0	42,500	293,500
Bileta kulle	266,800	23,250	51,800	238,250
Bileta treni	670,000	6,850	330,000	346,850
Bileta piste	152,100	1,662,100	1,050,100	764,100
Bileta shfaqje	95,677	88,550	67,289	116,938
<b>Totali</b>	<b>13,612,577</b>	<b>12,974,750</b>	<b>16,634,689</b>	<b>9,952,638</b>

#### 2. Llogaritë e klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Lekë

Gjendja e llogarive të Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” më datë 31.12.2024, në pasqyrat financiare të konsoliduara				
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023
31	Materiale	86,455,325	84,027,765	2,427,560
32	Inventar i imët	116,349,677	137,679,760	(21,330,083)
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0	0
34	Produkte	10,154,065	9,489,435	664,630
35	Mallra	0	0	0
36	Kafshë në rritje e majmëri	0	0	0
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provizione për zhvlerësimin e inventarit (-)	0	0	0
Totali		212,959,067	231,196,960	(18,237,893)

Megjithëse dokumentacioni justifikues rezultoi i plotë, auditimi konstatoi dy mangësi të rëndësishme:

1. Arkëtimet në njësitë administrative janë për efekt të pagesave nga ana e banorve të njësive lidhur me detyrime për taksa tarifa vendore, si të tilla të gjitha këto janë mbi limitin e veprimeve të lejuara nëpërmjet arkës (limit i lejuar për veprimet me arkë është 1000 lekë).

2. Mungesë ndarjeje funksionesh në veprimtarinë e arkës. Në Bashkinë Korçë, veprimet e lëshimit të mandat-arkëtimit, administrimit të arkës dhe regjistrimit kontabël kryhen nga i njëjti punonjës, duke cënuar parimin e ndarjes së funksioneve.

Mosrespektimi i kufizimeve për veprimet cash dhe mungesa e ndarjes së funksioneve rrit riskun e administrimit të fondeve.

- Bashkia Korçë duhet të gjatë periudhës ushtrimore duhet të kishte marrë masa për forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm për administrimin e arkës, duke siguruar respektimin e kufizimeve ligjore për veprimet cash ose administrimin e tyre nëpërmjet agjentëve Posta shqiptare e tj.

- Të sigurohej ndarja e funksioneve në të gjitha njësitë që administrojnë të ardhura cash, duke shmangur rastet kur i njëjti punonjës kryen autorizimin, arkëtimin dhe regjistrimin.

- Të vendosej kontroll periodik i arkës (kontrolle të papritura, rakordime mujore, verifikime të barazimit të veprimtarisë dhe ngjarjeve të pasqyruara në mandat arkëtime /Pagesa me librin e Arkës dhe më tej me atë të bankës).

- Të organizonte trajnime për punonjësit e arkës dhe drejtuesit e njësive administrative mbi kërkesat e kuadrit regullator dhe procedurat standarde të administrimit të arkës.

**Banka:** Nga auditimi i veprimeve në arkën e Bashkisë Korçë dhe njësive të varësisë u konstatua se transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët. Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve

të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj.,.

Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore.

Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore konstatohet se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

Nga auditimi i ditarit të shpenzimeve rezultoi se janë regjistruar të gjitha faturat, shpenzimet operative dhe investimet afatgjatë materiale. Gjatë auditimit të ditarit të shpenzimeve u verifikua se janë respektuar kërkesat sipas udhëzimit nr.8 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar dhe standartet kombëtare të kontabilitetit.

Në ditarin e shpenzimeve janë regjistruar shpenzimet me të gjithë elementët e tyre siç janë nr.rendor, nr.i urdhër shpenzimit, përshkrimi i veprimit dhe vlera e shpenzimit. Gjithashtu u verifikua se përveç regjistrimit kronologjik të faturave ishte kryer edhe kontabilizimi i tyre sipas llogarive përkatëse.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 në ditarin e shpenzimeve janë kontabilizuar 1372 shpenzime mesatarisht rreth 114 shpenzime në muaj, me vlerë totale 1,677,349,479 lekë.

U auditua edhe ditari i bankës ku rezultoi se regjistrimi i urdhër shpenzimeve ishte kryer i detajuar, sipas elementeve të urdhër shpenzimit sic janë nr.rendor, nr. urdhër shpenzimi, vlera e likujdimit të faturës, përshkrimi i shpenzimit të kryer, si dhe klasifikimi i shpenzimit sipas llogarive përkatëse, në zbatim të udhëzimit nr.8 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar.

U verifikua se gjatë procesit të likujdimit të faturave janë zbatuar politikat e programit buxhetor të miratuara sipas 11 programeve buxhetore. Gjatë muajit dhjetor u kontrolluan me zgjedhje 50 urdhër shpenzime të listuara si më poshtë, nga të cilat 16 urdhër shpenzime ishin për investime dhe 34 për shpenzime operative. Për të gjitha Urdhër shpenzimet u konstatua se dokumentacioni bashkëngjitur ishte konform kërkesave ligjore. Analiza e detajuar paraqitet (në Aneksin nr. 1, Tabela nr. 14.).

#### ➤ **Veprimet nëpërmjet magazinës:**

- Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje konstatohet se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

- Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara nga titullari i institucionit.

- Janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre ekziston viti i krijimit si dhe janë evidentuar shtesat dhe pakësimet për to, por nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet

në llogaritë e bilancit në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 30.

- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjesisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

➤ **Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore në kryerjen e pagesave për pagat e punonjësve, shtesat mbi to, shpërblimeve.**

Nga Bashkia Korçë është mbajtur dhe përditësuar libri dhe ditari i pagave. Ato hartoheshin sipas standardeve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave deri tek paga neto. Përmbledhëset janë të kuadruar me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkuara nga punonjësi i financës dhe titullari. Për të gjithë periudhën e kontrolluar, janë përlllogaritur, ndaluar dhe xhiruar detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat. Janë respektuar strukturat organike të miratuara përsa i përket numrit të punonjësve si dhe janë respektuar dispozitat ligjore për kohëzgjatjen e punës.

**Numri i punonjësve dhe fondi i pagave:**

Pasqyra nr. 8, jep informacion mbi numrin e punonjësve, ndryshimet gjatë vitit ushtrimor të mbyllur si dhe gjendjen në fund të periudhës, fondin e pagave gjithsej, kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe informacion mbi tatimin mbi të ardhurat. Bashkëlidhur janë edhe llogaritë debitore dhe kreditorë në mënyrë analitike, si dhe evidencën përmbledhëse të përdorimit të fondeve.

*Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Bashkia Korçë janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit me shkresën 10576/12 prot., datë 15.01.2026, administruar në KLSH me praktikën nr. 974/5 prot., datë 19.01.2026, nga z. S. F. Kryetar i Bashkisë Korçë dhe znj. V. Z. Drejtor i Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:*

**1. Pretendimi i subjektit:** *Në përgjigje të Projekt-Raportit të Auditimit, tek gjetja nr. 5, lidhur me kuadrimin e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin” në aktivet e Pasqyrës së Pozicionit Financiar me totalin e logarive të klasës 4 në pasivet e Pasqyrës së Pozicionit Financiar, ju sqarojmë se:*

*Në zbatim të Udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në pasqyrat financiare të NjQP paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime/shërbime të kryera gjatë periudhës ushtrimore, të rimbursueshme nga shteti në baze të kuadrit ligjor ose marreveshjet e financimit për projekte të ndryshme.*

*Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (debitor)” përbëhet nga totali i llogarive 401 “Furnitorë dhe logari të lidhura me to”, 42 “Detyrime ndaj personelit”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, 435 “Sigurime shoqërore”, 436 “Sigurime shëndetsore” dhe 467 “Kreditorë të tjerë”. Në llogarinë 467 “Kreditorë të tjerë”, përjashtohet vlera e letrave me vlerë (pulla të gjendjes civile), pasi ato hyjnë në përbërje të llogarisë 468 “Debitore të ndryshëm”.*

*Llogaria 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to” është e përbërë nga llogaria 401 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, e cila përmban faturat e palikujduara për shpenzime korrente dhe hyn në përbërje të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin debitor”, ndërsa llogaria 404 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to” në vlerën 23,143,127 lekë përmban fatura të pa*

likujduara për investime kapitale” dhe paraqitet në aktivet e bilancit në llogarinë 231 “Shpenzime për aktive afatgjata materiale”.

Në bazë të Udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, faqe nr. 6, pika 6 citohet se:

6. Në rubrikën 2.3, “Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik”, pika 20 ndryshon si më poshtë:

Llogaritë e detyrimeve financiare për t’u paguar në klasën 4 funksionojnë si më poshtë vijon:  
a) Detyrimet financiare në kontabilitetin publik konstatohen në çastin e pranimit të dokumentit financiar nga palët e treta, i cili si rregull përkon me datën e lëshimit të dokumentit financiar, përveç rasteve kur autoriteti publik e ka kundërshtuar me shkrim.

Regjistrimi kontabël në këtë rast është si më poshtë:

Kreditohe llogaria përkatëse e klasës 4; dhe

Debitohe llogaria përkatëse e shpenzimeve (klasa 6) dhe e investimeve (klasa 2, grupi 23)

Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, faqe 6

- Pasqyra e Performancës Financiare dhe Shpenzimet e llogarisë 23 të NJQP-së pasqyrojnë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet publike të kryera gjatë vitit ushtrimor, pavarësisht alokimeve buxhetore vjetore, por të kryera sipas legjisllacionit në fuqi, përfshirë detyrimet financiare qoftë brenda afateve ligjore, qoftë të prapambetura.

- Pasqyra e Performancës Financiare (PPF) dhe Llogaria 23 gjeneruar nga SIFQ pasqyrojnë të gjitha arkëtimet dhe shpenzimet publike të vitit ushtrimor të kryera në bazë të alokimeve buxhetore, duke përfshirë detyrimet financiare që rezultojnë në fund të vitit vetëm për shpenzimet publike, të regjistruara në sistem muajin e fundit të vitit dhe të papaguara.

Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, faqe nr. 21, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 21 “aktive afatgjata materiale”, thuhet se për konstatimin e shpenzimeve për blerjen e aktivitet kryhet verimi kontabël:

Debitohe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”;

Kreditohe llogaria 404 “Furnitorë për investime”.

Në momentin që fatura nuk arrin të likuidohet në fund të vitit ushtrimor ajo mbetet detyrim në bilanc, pra detyrimisht pasqyrohen në aktivet e bilancit në llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe në llogarinë 404 “Furnitorë për investime”.

Pikërisht kjo shpjegon diferencën që paraqitet në bilanc midis totalit të llogarive të klasës 4 me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin të drejta”.

Ky interpretim është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Të dhënat më datë 31.12.2024, sipas pasqyrave financiare të njëjësive shpenzuese	
401	20,370,151
42	65,092,617
431	4,868,646
435	19,424,995
436	2,685,069
467	22,355,300
4342	134,796,778

Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018, faqe 8

Të drejtat duhet të evidentohen në kohën e lidhjes së tyre, ndërsa si të ardhura njihen dhe evidentohen në pasqyrat financiare në çastin e arkëtimit të tyre në llogaritë financiare, duke mbajtur në kontroll evidentimin e të ardhurave me baza rritëse (logaria 7206 "financim i pritshëm nga buxheti"), të cilat evidentojnë të drejta të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në marrëdhënie me shtetin (llogaria 4342 "operacione me shtetin të drejta"). Në këto kushte kur këto detyrime dalin në pasqyrën e performancës financiare, ku llogaria 7206 "financim i pritshëm nga buxheti" balancohet me detyrimet financiare të pasqyruara në llogaritë e Shpenzimeve operative të klasës 6, nëse përfshijmë detrimet financiare të llogarisë 404 duke

qenë se shpenzimet për investime pra llogaria 23, nuk paraqitet në këtë pasqyrë, atëherë matematikisht pasqyra e performancës financiare nuk do të jetë e kuadruar.

**Rekomandim 12.1**

Në gjetjen nr. 12, është përshkruar se vlera e llogarisë 231 "Për aktivet afatgjata materiale" 168,001,879 lekë nuk kuadron me totalin e vlerave të llogarisë 105 "Teprica e granteve kapitale të brendshme" e cila është 127,694,438 lekë dhe llogarisë 115 "Nga fondet e veta për investime", e cila është 23,143,126 lekë dhe diferenca midis vlerës së llogarisë 231 me totalin e vlerave të logarive 105 + 115 është 23,143,126 lekë, e cila perfaqëson detyrimet financiare për investime kapitale. Në zbatim të udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, sqarojmë se:

Udhëzimi nr. 5 datë 21.2.2022, fage 12

Funksionimi i llogarisë së granteve kapitale të brendshme (105) është si më poshtë:

a) Llogaritë 1050, 1051 e 1052, që përfaqësojnë grante kapitale dhe kontribute të të tretëve për investime, marrin në kredi vlerën e këtyre granteve, në kundërparti:

- Debitin e Logarisë 476 "Të ardhura të caktuara për t'u përdorur" (n.q.s. këto Grante tranzitohen nëpërmjet kësaj Llogarie).

- Debitin e logarisë 520 "Disponibilitete në Thesar", për Grantet Kapitale të brendshme të arkëtuara (kur Fondet nuk tranzitohen nëpërmjet llogarisë 476, por direkt nëpërmjet llogarisë 520 "Disponibilitete në Thesar").

b) Logaria 1059 "Grante kapitale të brendshme në natyrë" marrin në kredi vlerën e aktiveve të dhuruara nga donatorë të brendshëm (të marra në dorëzim dhe të bëra hyrje në institucion), në debi të logarive përkatëse të aktiveve (grupet e logarive 20 dhe 21).

c) Logaritë 105 mbeten me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces të institucioneve (të papërfunduara ose të pamarrë në dorëzim). Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e logarive 23.

Këto mbyllen (kapitalizohen) me fondet bazë (logaria 101) në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim.

Logaria 115 "Caktim fondi për investime nga rezultati i vitit". Krijimi i këtij burimi ka të bëjë me ato njësi (sidomos organet e pushtetit vendor), që të ardhurat e realizuara gjatë vitit.

Udhëzimin nr. 8, për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme faqe 47 rubrika "llogaria 63" ndryshimi i gjendjes së inventarit", citohet se "kjo kategori ka veçori për sektorin publik, se nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë ose pakësim të fondeve bazë (llogaria 101) të institucioneve.

Shënim përmbledhës: Amortizimi i akumuluar i aktiveve në datën 31.12.2023, është në vlerë -3,151,983,214 lekë (shenjë negative), shtesat e amortizimit janë në vlerën -708,458,770 lekë (shenjë negative), pakësimet e amortizimit janë në vlerën + 235,777,503 lekë (shenjë pozitive), pra amortizimi i akumuluar në fund të vitit 2024 është :

$-3,151,983,214 - 708,458,770 + 235,777,503 = -3,624,664,481$  lekë, ndërsa amortizimi i vitit 2024 është:

$-708,458,770 + 235,777,503 = -472,681,267$  lekë

dhe jo

$-708,458,770 - 235,777,503 = -944,236,273$ , (gabim në llogaritje) pasi pakësimet e amortizimit kanë shenjë të kundërt me shtesat e amortizimit. (Formati I bilanc i konsoliduar Bashkia Korçë).

**1.1. Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Referuar bazës ligjore që citohet nga ana Juaj konkretisht Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, faqe nr. 21, nuk evidentohet paragrafi që paraqitet në këtë observacion konkretisht "Në momentin që fatura nuk arrin të likujdohet në fund të vitit

ushtrimor ajo mbetet detyrim në bilanc, pra detyrimisht, pra detyrimisht pasqyrohet në aktivet e bilancit në llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe në llogarinë 404 “Furnitorë për investime”. Për më tepër në Aneksin nr. 1, të këtij udhëzimi citohet se “Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm”. **Për sa trajtuar më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.**

**1.2. Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Dispozita ligjore dhe argumentet që paraqiten në këtë observacion nga ana Juaj cilësojmë veprimet rregulluese për sa i përket kontabilizimit të detyrimeve për fatuarat e pa likuiduara të kontratave të investimeve, ndërsa rasti i evidentuara nga grupi i auditimit ka të bëjë me shpenzimet kryera për kontratat e investimeve të cilat janë në proces të cilat duhet të kontabilizohen në llogarinë 231 “Shpenzime për aktive afatgjata materiale” konkretisht: Për vitin 2024 është një kontratë që ende nuk kanë përfunduar punimet për të cilën është lëshuar Situacioni i Punimeve nr. 1, në vlerën 18,419,712 lekë sipas faturës tatimore nr. 1055, datë 08.11.2024, për të cilë është kryer likuidimi në vlerën totale pre 15,419,712 lekë, sipas Urdhër Shpenzimeve nr. 435, datë 05.12.2024, në vlerën 5,419,712 lekë, nr. 470, datë 24.12.2024, në vlerën 5,000,000 lekë dhe nr. 473 prot., datë 27.12.2024, në vlerën 5,000,000 lekë që i përket kontratës së punimeve me nr. 699 prot., datë 22.08.2024, me objekt “Meremetimi i institucioneve arsimore”, me vlerë kontrate 28,397,436 lekë me Tvsh dhe me afat 10 muaj nga nënshkrimi i kontratës, e cila nuk është kontabilizuar në gjendjen e kësaj llogarie. Për më tepër në Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, faqe nr. 20, citohet se: “..... Për rrjedhim, aktivet afatgjata para se të vihen në shfrytëzim, pra të jenë funksional, ato detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23 “Investime”. Këto janë investime në proces, pra aktivi ende nuk është përfunduar dhe detyrimisht nuk është në funksionim dhe nuk është kapitalizuar”. **Për sa trajtuar më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.**

**1.3. Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Ne i referohemi parashikimeve të Udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, pika 17, në të cilën citohet se:

Për regjistrimin në kontabilitet të operacioneve që prekin llogaritë e pozicionit financiar (bilancit) ndiqet procedura e mëposhtme:

a) Llogaria 101 e klasës I funksionon si më poshtë:

Kreditohet për shtesat në fondet bazë që vijnë nga:

- Grantet kapitale për aktivet afatgjata të blera dhe të kapitalizuara;
- Grantet kapitale që vijnë nga dhurimet në natyrë të aktiveve afatgjata;
- Rivlerësimet në shtesë të aktiveve afatgjata;
- Anulimet e detyrimeve për t'u paguar; si dhe të tjera.

b) Debitohet për pakësimet në fondet bazë që vijnë nga:

- Shitja e aktiveve afatgjata, të vlerësuar me koston historike të blerjes së tyre
- Nxjerrjet jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata;
- Transferimet e dhurimet e aktiveve afatgjata;
- Konsumi i aktiveve afatgjata;
- Rivlerësimet në pakësim të aktiveve afatgjata; si dhe
- Anulimet e të drejtave për t'u arkëtuar; të tjera.

Në kushte të tilla veprimet kontabël që duhet të kryheshin si më poshtë: Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën

11,640,591,748 lekë. Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" në vlerën 1,707,011,296 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 58,582,426 lekë sipas llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit". Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 1,580,107,864 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2024 në vlerën 944,236,273 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)". Sipas informacionit kontabël llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" është nënvlerësuar në vlerën 390,414,015 lekë. **Për sa trajtuar më sipër observacioni merret në konsideratë.**

## IV. REKOMANDIME

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Bashkia Korçë nuk ka ngritur një sistem funksional dhe të dokumentuar të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, pasi: Mungon një kuadër i plotë rregullash dhe procedurash të shkruara; Nuk është hartuar Kodi Etik; Në rregulloren e brendshme evidentohen mbivendosje të detyrave dhe kompetencave të Sektorit të Inspektimit dhe Mbrojtjes së Pyjeve; Nuk kanë hartuar dhe miratuar plane dhe programe vjetore efektive për trajnimin e detyrueshëm të punonjësve; Nuk ka miratuar plan pune vjetor lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik; Nuk është hartuar një strategji për trajnimin e personelit apo për menaxhimin e riskut, ndërsa regjistri i riskut është i paplotë dhe jo në përputhje me formatet standarde; Nuk evidentohet puna e anëtarëve të GMS, përfshirë dokumentimin e mbledhjeve dhe takimeve për hartimin e planit strategjik dhe PBA-së. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 4, pikat 19-20, neni 8, gërma "a", neni 16, pikat 1-3, nenet 20-22, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2.1, gërmat "a-d", pika 2.3.1, pika 3.2.1, pika 5.2.3, pika 5.2.7, dhe "Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108/2016, datë 17.11.2016, Kapitulli III. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 13-27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Korçë të marrë masa konkrete për analizimin dhe adresimin e mangësive të konstatuara, si dhe të sigurojë ngritjen dhe funksionimin e një sistemi të përshtatshëm të rregullave dhe procedurave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në funksion të përmirësimit të veprimtarisë institucionale.

### Menjëherë dhe në vijimësi

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Korçë përgjatë vitit 2024, u konstatua se:

- Për periudhën 2024, nuk janë mbuluar me auditim të gjitha sistemet, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë;
- Në auditim është përfshirë një punonjëse, e cila nuk ka qenë pjesë e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm;
- Plani i auditimeve nuk është realizuar, nga 7 auditime të planifikuara janë realizuar vetëm 5 prej tyre;

- Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore;  
- Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar. Këto veprime janë në kundërshtim me: *gërma “a”, pika 1, neni 10; gërma “a”, neni 12; gërma “a”, neni 14, të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, si dhe pika 3, neni 43 të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020, të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016”; Udhëzimin nr. 42, datë 27.10.2020, “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”, Kreun IV paragrafi 4.1.13.1 të Manualit për Auditimin e Brendshëm. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 13-27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Korçë, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisht të lartë, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve etj, në mënyrë që t’i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave institucional.

**Në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin 2024 të Bashkisë Korçë, ku përfshihen edhe pasqyrat financiare të Njësisë Shpenzuese “Shtëpia e Foshnjës ‘Lulet e Vogla’”, u konstatua se këto pasqyra janë depozituar jashtë afatit ligjor në Degën e Thesarit Korçë. Konkretisht, ato janë përcjellë me shkresën nr. 104 prot., datë 28.04.2025, dhe janë konfirmuar nga Dega e Thesarit Korçë me praktikën nr. 104, datë 30.04.2025. Këto veprime janë në kundërshtim me: Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kapitulli V, pika 118. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Nga Sektori i Financës të Shtëpisë së Foshnjës “Lulet e Vogla” të merren masa që hartimi dhe depozitimi i pasqyrave financiare vjetore, pranë degës së thesarit, të kryhet brenda afatit të përcaktuar në dispozitat ligjore përkatëse.

**Në vijimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procesit të inventarizimit të Njësisë Shpenzuese Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla” u konstatua se, në pasqyrat financiare nuk janë kryer veprimet sistemuese për pakësimin e vlerës totale prej 1,055,907 lekë që i përket llogarive 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në vlerën 21,000 lekë, 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 740,499 lekë dhe 327 “Inventar i imët” në vlerën 294,408 lekë që i përket aktiveve të asgjësuar, të cilat ndodhen ende në inventarin fizik të institucionit. Këto veprime janë në kundërshtim me: Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pikat 89-90. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Korçë në bashkëpunim me Njësinë Shpenzuese Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla” të marrë masa që, në pasqyrat financiare të vitit 2025 të kryejë sistemimin e vlerës totale prej 1,055,907 lekë, që i përket aktiveve të asgjësuar në procesin e inventarizimit të vitit 2024, duke i pakësuar nga gjendja e inventarit kontabël.

## Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2025

**5. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 75,078,510 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 134,796,778 lekë me një rritje në vlerën 59,718,268 lekë e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, për detyrime paga, tatime taksa dhe sigurime shoqërore dhe furnitorë e llogari të lidhura me to. Kjo llogari nuk kuadron me përmbledhësen e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” 43,513,278 lekë; 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 65,092,617 lekë; 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 4,868,646 lekë; 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 19,424,995 lekë; 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 2,685,069 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 22,615,430 lekë, ku totali shkon në vlerën 158,200,035 lekë me një diferencë në vlerën 23,403,257 lekë. Sipas informacionit kontabël llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është nënvlerësuar në vlerën 23,403,257 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me: Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1, Kapitulli 3.3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Rekomandimi:** Bashkia Korçë, Drejtoria e Financës Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në bashkëpunim me NShMAC, QDZh të marrë masa që në pasqyrat financiare të konsoliduara të vitit 2025 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

## Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2025

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” pasqyruar në mbyllje datë 31.12.2024, në vlerën 4,215,948,779 lekë është përfshirë vlera 710,580 lekë me emërtimin “Dhomë Serverash” që kanë të bëjnë me pajisje elektronike me emërtimet kamera, switch, aspiratorë profesional etj., të cilat i përkasin llogarisë 218 “Inventar ekonomik”. Regjistrimet e mësipërme kanë mbivlerësuar llogarinë 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 710,580 lekë dhe kanë nënvlerësuar llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në vlerë 710,580 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me: Nomeklaturën e Llogarive të Planit Kontabël Publik, Llogaritë e Klasës 20; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1. Rekomandimi:** Bashkia Korçë, Drejtoria e Financës Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masa për sistemimin e vlerës 710,580 lekë që i përket aktivitet me emërtimin “Dhomë Serverash” së bashku me vlerën e amortizimit të përlllogaritur, duke e pakësuar si aktiv nga llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe duke e kontabilizuar në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse.

## Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2025

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e llogarisë 215 “Mjete transporti”, e pasqyruar në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2024 në vlerën 275,350,932 lekë, u konstatua se në përbërje të saj është përfshirë edhe vlera prej 950,000 lekë, e cila i përket një automjeti të llojit Volkswagen Furgon, me targë AB0840, pjesë e inventarit të Qendrës Rezidenciale të Zhvillimit. Nga dokumentacioni i administruar dhe nga procesi i vlerësimit të aktiveve rezulton se automjeti në fjalë nuk ndodhet në gjendje pune dhe është vlerësuar nga komisioni përkatës si aktiv për jashtë

përdorimit, ndërkohë që gjatë vitit 2024 nuk është ndjekur procedura e nxjerrjes nga përdorimi dhe, për rrjedhojë, vlera pasqyrohet ende në llogarinë 215 “Mjete transporti”.

Bazuar në sa më sipër, vlera prej 950,000 lekë, që përfaqëson koston historike të mjetit të dëmtuar, duhej të ishte trajtuar në kontabilitet si pjesë e llogarisë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”, dhe jo si mjet transporti funksional. Këto veprimet janë në kundërshtim me: Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi nr. 1, pika 2.1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1. Rekomandimi** Bashkia Korçë, nëpërmjet Drejtorisë së Financës, Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, në bashkëpunim me Qendrën Rezidenciale të Zhvillimit, të marrë masat që:

- vlera 950,000 lekë, që i përket koston historike të këtij mjeti, të ç’regjistrohet nga llogaria 215 “Mjete transporti” dhe të trajtohet në kontabilitet si pjesë e llogarisë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”, duke u reflektuar korrekt në pasqyrat financiare të vitit 2025.

- për automjetin e dëmtuar të llojit *Volkswagen Furgon*, me targë AB0840, të ndiqet procedura përkatëse e nxjerrjes nga përdorimi, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi;

**Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2025**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)” për llogarinë 218 “Inventar ekonomik” është përlllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 25,787,766 lekë (kosto historike), me normë amortizimi 20%. Ndërkohë, nuk është kryer ndarja e nënlllogarisë 218/6 “Pajisje kompjuterike” nga llogaria bazë 218 “Inventar ekonomik”, për të cilën norma e amortizimit e aplikueshme është 25%, si pasojë aplikimi i normës së amortizimit është i pasaktë. Këto veprimet janë në kundërshtim me: Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 36. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandimi:** Bashkia Korçë, Drejtoria e Financës Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masat për të klasifikuar veçmas llogarinë 218/6 “Pajisjet kompjuterike” brenda llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në regjistrin e asetëve të njëjësive dhe në pasqyrat financiare, konform kërkesave të nomenklaturës së llogarive, duke aplikuar amortizimin sipas normës përkatëse për çdo aktiv.

**Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2025**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, në gjendjen e llogarive 202 “Studime dhe kërkime” në vlerën 57,852,130 lekë kosto historike është përfshirë vlera 1,166,300 lekë; 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 4,348,849,060 lekë kosto historike, është përfshirë vlera 414,379,276 lekë; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 4,544,741,034 lekë kosto historike është përfshirë vlera 767,685,964 lekë dhe 215 “Mjete transporti” në vlerën 219,912,236 lekë kosto historike është përfshirë vlera 8,833,400 lekë, të cilat janë të paanalizuara si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Këto vlera janë të trashëguara nga bilanci i ish-komunave Korçë të pa analizuar dhe ndikojnë në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me: Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30,

74 dhe 85, dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1. Rekomandimi:** Bashkia Korçë, Drejtoria e Financës Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të kryejë detajimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

## Menjëherë dhe në vijimësi

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” nuk është përfshirë vlera e aksioneve në shumën totale 722,601,823 lekë, që i përket pjesëmarrjes së Bashkisë Korçë në kapitalin e shoqërive tregtare dhe publike, konkretisht: “Tregu i shitjes me shumicë fruta e perime” Sh.A në vlerën 275,000,000 lekë (100% aksionare); “Korça” Sh.A (100% aksionare); “Qendra Sportive Korçë” Sh.A në vlerën 36,110,000 lekë (100% aksionare); Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë, me pjesëmarrje 28.29% ose 2,829,300 lekë sipas Marrëveshjes nr. 5767 prot., datë 28.09.2022; si dhe “KRËM” Sh.A, me pjesëmarrje 41% ose 1,533,523 lekë. Ndërkohë, llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më datë 31.12.2024 paraqitet në vlerën 0 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me: Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, pika 31. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27–73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Korçë, Drejtoria e Financës Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të merren masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.

## Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2025

**11. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 231 “Për aktivet afatgjata materiale” më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 170,137,677 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 114,087,086 lekë dhe pakësime në vlerën 111,951,288 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 168,001,879 lekë. Nga auditimi i kontratave të investimeve në proces u konstatua se për kontratën nr. 699 prot., datë 22.08.2024, me objekt “Meremetimi i institucioneve arsimore”, me vlerë kontrate 28,397,436 lekë me TVSH, është likuiduar vlera 15,419,712 lekë, sipas dokumentacionit financiar përkatës, vlerë e cila nuk është kontabilizuar në llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”. Si pasojë, llogaria 231 rezulton e nënvlerësuar në vlerën 15,419,712 lekë, duke ndikuar në informacionin kontabël që japin pasqyrat financiare. Këto veprime janë në kundërshtim me: Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1, Klasa 23. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Korçë, Drejtoria e Financës, Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të merren masat e nevojshme për kontabilizimin e vlerës 15,419,712 lekë në

llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, që i përket likuidimeve të situacioneve pjesore të kontratave të investimeve në proces zbatimi.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2025**

**12. Gjetje nga auditimi:** Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 168,001,879 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 168,001,879 lekë, nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 17,164,315 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grondeve kapitale të brendshme” në vlerën 127,694,438 lekë, me një diferencë në vlerën 23,143,126 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me: Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1, gërma “c”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1. Rekomandimi:** Bashkia Korçë, Drejtoria e Financës Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në bashkëpunim me NShMAC-në të evidentojë pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, në llogaritë 230 - 231 “Investime në proces” me kundërparti llogaritë 105 “Teprica e grondeve kapitale të brendshme”, 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar dhe në llogarinë 101 “Fondi Bazë”.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2025**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore dhe Pronës Publike.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

### **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**